



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

DIVIZIONI PËR SIGURIM TË CILËSISË, STANDARDE, VLERËSIM DHE LICENCIM

TESTI I MATURËS

Gjuhë Shqipe dhe Letërsi
Gjuhë Angleze
Matematikë
Lënda Zgjedhore

Emri dhe mbiemri i nxënësit

Shkolla

Forma



Qershor, 2023

Udhëzime

Koha:

Keni 150 minuta që t'u përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Luteni që të verifikoni a është e njëjtë forma e **Testit** me formën e **Fletëpërgjigjes** (A me A, B me B, etj.)
2. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
3. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
4. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.

Numri **1(një)** paraqet numrin e pyetjes në fletën e përgjigjeve

Përgjigja e saktë, në fletën e përgjigjeve, duhet plotësuar në këtë mënyrë me laps të thjeshtë HB



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në **Test** dhe në **Fletëpërgjigje**.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

Për këtë rrëfim tepër të frikshëm, por edhe po kaq të rëndomtë që po hedh në letër, nuk pres, dhe as i lutem njeriu të më besojë. Dhe, ç'është e vërteta, do të isha i marrë, po ta shpresoja një gjë të tillë, mbasi edhe logjika më e thjeshtë nuk e përtyt dot atë që më panë sytë. Por, një ditë do të vdes, prandaj dhe sot dua ta heq këtë peshë nga shpirti im. Qëllimi im i vetëm është që t'i tregojë botës hapur, sheshit, shkurt, saktë, e pa zbulurime, një varg ndodhish të çuditshme në shtëpinë time. Ato ngjarje më kanë tmerruar, më kanë torturuar, më kanë shkatërruar...

Uroj, që, të paktën për ju, me një arsye me të shëndoshë, me një logjikë më të qetë dhe pa nervozizëm, siç ndodhi me mua për rrethanat që m'u krijuan, ta trajtoni si diçka krejt të zakonshme e të ndodhur për shkaqe krejt normale.

Që fëmijë kam qenë një natyrë e bindur dhe e brishtë. Kaq shumë binte në sy butësia e zemrës sime, saqë shokët më vinin në lojë. Isha i dhënë, veçanërisht, pas kafshëve, prandaj dhe prindërit ma bënë qejfin e më llastuan me shumë kafshë shtëpiake. Me to kaloja shumicën e kohës, dhe ndihesha aq i lumtur kur i ushqoja dhe i përkëdhelja...!

Jam martuar herët, dhe sa mirë që njoha tek ime shoqe një gatishmëri të ngjashme me timen. Ajo e vuri re shpejt dobësinë time për kafshët shtëpiake, dhe nuk la rast t'i ikte për të kërkuar ato më të lezetshmet. Kishim zogj, peshk të kuq, një qen të zgjuar, lepuj, një majmun të vogël, dhe një mace.

Më vonë, macja jonë u rrit, u bë një kafshë e madhe dhe e bukur; e gjitha e zezë, dhe me një nuhatje mahnitëse. Kur fliste për inteligjencën e saj, gruaja ime, e cila ishte edhe disi supersticioze, kujtonte një pikëpamje të lashtë popullore, sipas së cilës, të gjitha macet e zeza ishin, thjesht, shtriga të maskuara...

Pluto, kështu quhej macja, ishte kafsha ime e preferuar dhe e kisha shok loje. E ushqoja vetë, dhe ajo më shoqëronte kudo nëpër shtëpi. Mezi e ndaloja të më vinte pas kur dilja në rrugë.

Në këtë mënyrë, miqësia jonë zgjati për shumë vite, gjatë të cilëve, temperamenti dhe karakteri im (më vjen turp ta rrëfej) pësoi një ndryshim rrënjësor për keq. Ditë pas dite, humori im ndryshonte. Me hënë, siç i thonë. U bëra gjaknxehtë, kisha më pak kujdes ndaj ndjenjave të të tjerëve... Megjithatë, për Pluton kisha goxha merak se mos e keqtrajtoja. Ndërkohë, u tregova i paskrupullt edhe ndaj lepujve, majmunit, por, edhe ndaj qenit, kur ndonjëri më dilte përpara pa dashje, ose më përkëdhelte. Por, me kalimin e kohës, sëmundja m'u shtua - sëmundje si alkooli! Edhe Pluto, e cila kishte nisur të mplakej, ishte bërë ca grindavece. Kishte filluar t'i ndiente edhe ajo efektet e gjendjes sime të keqe shpirtërore.

Një mbrëmje, kur po kthehesha në shtëpi nga një lokal i qytezës, xurxull fare, vërejtja që macja më shmangej. E mbërtheva fort. Nga frika se mos e dhunoja, më kafshoi me dhembë dorën. Në çast, më pushtoi një tërbim djalli. Nuk e njoha më veten. Shpirti, dukej se më kishte dalë nga trupi, dhe diç më e fortë se ligësia mizore, e ushqyer edhe nga xhini që kisha pirë, më pushtoi çdo qelizë. Mora nga xhepi i jelekut një biçak, e hapa, rroka nga fyti kafshën e gjorë, dhe me ngadalë, ia nxora njërin sy nga zgavra! Po më vjen turp, digjem, ngjethem, teksa përshkruaj këtë egërsi të neveritshme.

Me mëngjesin, m'u rikthye mendja e shëndoshë. E kisha marrë veten nga xhindosja e natës së shkuar. Ndjeva gjysmëlemeri, e gjysmëpendesë për krimin që kreu; ndonëse ishte veç një ndjesi e dyshimtë, kështu që shpirti më mbeti i paprekur. Sërish e teprova, dhe pak më vonë, i mbyta me verë tërë kujtimet e asaj që bëra.

Ndërkohë, macja, ca ngadalë, po e mori veten. Vërtet, zgavra e syrit që i mungonte ishte ca e frikshme, por mesa dukej, nuk ndjente më dhimbje. Vinte rrotull shtëpisë, si zakonisht, por, -doemos, - siç pritej, nuk më afrohej aspak. U vrerosa nga shpërfillja e dukshme e asaj krijese që më kishte dashur kaq shumë dikur. Veçse, shpejt, kjo ndjesi ia la vendin irritimit. E, më pas, si ndryshim i mbramë dhe i pakthyesëm, depërtoi brenda meje shpirti i perversitetit, që u bë pjesë e qenies sime.

Edgar Allan Poe, "Macja e zezë"

1. Çfarë thotë tregimtari për historinë të cilën nis të na e tregojë që në fillim të këtij rrëfimi?

- A Është një histori për të cilën nuk do të priste ta besonte kush.
- B Është një histori e familjes së tij që nuk do të duhej treguar.
- C Është një histori të fshehtë e së cilës do ta zbulojë në prag të vdekjes.
- D Është një histori që nuk e di as vetë pse po e zbulon të tërën.

2. Rrëfyeni në këtë tregim përshkruan ngjarje të jetës së tij qëkurse:

- A mbyti macen e deri në fund të jetës
- B ishte fëmijë e deri në moshën e pjekurisë
- C u shkurorëzuar e deri kur u plak
- D ishte fejuar e deri në kohën kur u martua

3. Rrëfytesi përshkruan ngjarjet që ndodhin në:
- A vendin e tij të punës
 - B shtëpinë e shërbëtores
 - C qendrën rehabilituese
 - D shtëpinë e tij
4. Çfarë qëndrimi kishte protagonistin në këtë tregim në fazën e fëmijërisë?
- A Të ftohtë e mospërfillës
 - B Të ashpër e të pamëshirshëm
 - C Të sjellshëm e të kujdesshëm
 - D Të druajtur e të paguximshëm
5. Çfarë pëlqente në fëmijërinë e tij protagonistin në këtë historië?
- A Lulet
 - B Kafshët
 - C Kanionet
 - D Shpellat
6. Protagonisti i këtij tregimi tregon se në moshën që po e jetonte, po vuante për shkak të:
- A përdorimit të alkoolit
 - B ikjes nga vendlindja
 - C nëmës së gruas
 - D përdorimit të ilaçeve
7. Mënyra se si vepronte në fund me macen protagonistin në këtë historië, ishte sjellje:
- A provokuese
 - B normale
 - C hakmarrëse
 - D tronditëse
8. Në fjalinë: “E, më pas, si ndryshim i mbramë dhe i pakthyesëm, depërtoi brenda meje shpirti i perversitetit, që u bë pjesë e qenies sime”, fjala “**perversitet**” e ka kuptimin:
- A revoltim
 - B ofendim
 - C çoroditje
 - D shqetësim
9. Çfarë përfundimi mund të nxjerrim pas leximit të këtij tregimi?
- A Tregimi zbulon psikikën njerëzore të njeriut dhe marrëdhënien e tij me të kaluarën.
 - B Tregimi zbërthen ndjeshmërinë e njeriut, pas t’i ketë ikur varësisë nga droga.
 - C Tregimi paraqet të fshehtat e botës së njeriut, i zhgënjyer nga miqtë e tij.
 - D Tregimi shpreh lidhjen e njeriut me religjionin, pas pendimit për të kaluarën e tij.

10. Në cilën fjali, tregimtari e përmend veten si një person, temperamentit dhe karakterit të cilin pësoi një ndryshim rrënjësor për të keq?
- (A) Një ditë do të vdes, prandaj dhe sot dua ta heq këtë peshë nga shpirti im.
- (B) Ato ngjarje më kanë tmerruar, më kanë torturuar, më kanë shkatërruar.
- (C) U bëra gjaknxehtë, kisha më pak kujdes ndaj ndjenjave të tjerëve
- (D) Gruaja e vuri re shpejt dobësinë time për kafshët shtëpiake.
11. Çfarë është e çuditshme dhe e pabesueshme për ne kur dëgjojmë rrëfimin e këtij tregimtari?
- (A) Si është e mundur që pas gjithë atyre sjelljeve dhe veprimeve, nuk ka asnjë dëshmitar që e denoncon edhe asnjë akuzë për ndjekje ligjore
- (B) Si vazhdon tregimtari të paraqesë arsyttime të shumta për sjelljen e tij, duke mos marrë asnjëherë përgjegjësi për atë që po bën
- (C) Si mund ta ndalë veten tregimtari të pijë alkool, kur e di se çfarë veprimesh të tmerrshme agresive bën, pa pasur asnjë shkas për këtë
- (D) Si mund të ruajë tregimtari, në këtë rrethanë kaq emocionale, qetësinë shpirtërore për të treguar një histori kaq të tmerrshme në një mënyrë kaq të kontrolluar

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

Edhe një aksident i rëndë në komunikacion në rrugën Prishtinë-Podujevë

Një grua vdiq në aksidentin në magjistralen Prishtinë-Podujevë

31 shtator 2018. - Një grua e moshës rreth 30 vjeçe ka vdekur sot si pasojë e një aksidenti të rëndë në trafik, të shkaktuar nga shpejtësia e madhe e automjeteve, që ndodhi rreth orës 13:30 në magjistralen Prishtinë-Podujevë. Rastin e ka konfirmuar zëdhënësja e Policisë në rajonin e Prishtinës.

“Rreth orës 13:30 e kemi pranuar informatën për një aksident trafiku në magjistralen Prishtinë-Podujevë, ku kanë qenë të përfshira tri automjete. Në këtë aksident lëndime trupore kanë pësuar tetë persona. Njëri nga të lënduarit (femër) nuk ka arritur të përballojë plagët e shkaktuara dhe e njëjta ka ndërruar jetë, ndërkohë që personat e tjerë të lënduar janë dërguar për tretman mjekësor”, tha zëdhënësja e Policisë së rajonit të Prishtinës.

Pamjet e kamerave në vend të ngjarjes tregojnë momentin e frikshëm, kur njëra veturë devijoi nga krahu i djathtë dhe qëlloi veturën që po lëvizte në krahun e majtë. Dëshmitarët në vendin e ngjarjes thanë se dëgjuan një zhurmë të fortë të shkaktuar nga ndeshja e dy veturave. Ata thanë se ishin të tmerruar nga lëndimet e rënda që kishin pësuar udhëtarët.

12. Cili është lajmi kryesor në këtë tekst?
- (A) Një grua vdiq në një aksident trafiku
- (B) Disa automjete u përfshinë në një aksident trafiku
- (C) Një aksident i ndodhur në një magjistrale
- (D) Shpejtësia e madhe e automjeteve në rrugë
13. Në pjesën themelore të lajmit përfshihen fakte, detaje dhe citime. Në cilën nga këto fjali është përdorur citati?
- (A) Dëshmitarët në vendin e ngjarjes thanë se dëgjuan një zhurmë të fortë të shkaktuar nga ndeshja e dy veturave.
- (B) Një grua e moshës rreth tridhjetë vjeçe ka vdekur sot si pasojë e një aksidenti të rëndë në trafik.
- (C) Pamjet e kamerave në vend të ngjarjes tregojnë momentin e frikshëm kur njëra veturë devijoi rrugën.
- (D) Rreth orës 13:30 e kemi pranuar informatën për një aksident trafiku në magjistralen Prishtinë-Podujevë.
14. Fjalitë: “Edhe një aksident i rëndë në komunikacion në rrugën Prishtinë-Podujevë”, në këtë pjesë të lajmit është dhënë si:
- (A) Nëntitull
- (B) Mbititull
- (C) Koment
- (D) Titull

15. Në fjalinë: “Në këtë aksident lëndime trupore kanë pësuar tetë persona”, fjala “pësuar” është:
- (A) paskajorja e foljes
 - (B) folje modale
 - (C) pjesore e foljes
 - (D) folje gjysmëndihmëse
16. Fjalja “Pamjet e kamerave në vend të ngjarjes tregojnë momentin e frikshëm, kur njëra veturë devijoi nga krahu i djathtë” është fjali me marrëdhënie :
- (A) shkakore
 - (B) kohore
 - (C) qëllimore
 - (D) shtuese

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim

Veprat e tij letrare shtrihen në shumë trajta, forma e gjini letrare. Ai që nga fundi i viteve njëzet nisi të shkruajë kritikë letrare sistematike në rubrikën *Shënime letrare*. Ai krijoi edhe një formë të veçantë të eseut që lidhet me interpretimin e veprave personale si të *Sulm e lotë*, e po ashtu për format paralettrare, duke analizuar tekstet e gurëve të varreve të *Në Prizren, midis të vdekurve e të gjallëve*. Po, rëndësia e veprës së tij, në rrjetën e vlerave të letërsisë shqipe, lidhet me tregimet e novelat, me të cilat ai hap një kapitull të veçantë të prozës shqipe, madje një stil të veçantë të krijimit në prozë që do të ndiqet më vonë nga autorë të tjerë. Vepra e tij ishte e ndaluar apo gjysmë e ndaluar dhe s’u botua e plotë deri në vitin nëntëdhjetë. Pra, ky është fati i shkrimtarit që nuk iu përshtat sistemi, por edhe sistemi nuk e duroi atë si njeri të fjalës së lirë.

Sabri Hamiti, *Studime letrare*

17. Për cilin autor flitet, bazuar në të dhënat e tekstit më lart?
- (A) Për autorin, vepra e të cilit është lexuar dhe është përkthyer
 - (B) Për autorin e dënuar me burg për shkak të veprës
 - (C) Për autorin të cilit iu lejua të jetonte vetëm në qytet
 - (D) Për autorin vepra e të cilit ishte e censuruar
18. Cili është autori për të cilin flitet në tekstin më lart?
- (A) Mitrush Kutelin
 - (B) Martin Camajn
 - (C) Faik Konicën
 - (D) Ernest Koliqin
19. Sipas vlerësimeve të kritikut letrar, autori shquhet për gjininë letrare të:
- (A) dramës
 - (B) kritikës
 - (C) prozës
 - (D) poezisë

Lexo poezinë e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve në vijim**LAHUTA E VJETËR**

Lahuta pushon në trá
 pse mixha ka vdekë ka mot
 e nipat s' dijnë me i rá.
 Lahuta pushon në tym
 e dorca e saj e thyeme
 si gishtat e mixhës në vorr.
 Por kumti i lahutës i trashë, burmuer.
 duket se ndihet ke votra përsëri
 me kangën e vjetër që tret n'oxhak:
 Treqind çika nën shatorr in kânë.
 Njaj mâ t'mirës djali syt s'ia dán!
 Lahuta flet, mandej vajton
 me dridhjet e zanit të mixhës
 si qyqja n'pranverën e parë,
 tash gjarpni gdhendun në të leviz
 dhe trimat mbi gjoka me shpata t'hjekna
 fluturojn' n' për zhark...

Lahuta pushon në trá
 e gishtat e mixhës në dhé.
 por n'shpirtin e nipave ka mbetë
 nji tingull për kangën e ré.

Martin Camaj, "Nji fyell ndër male"

20. Cili është simboli në poezinë në të cilën autori shpreh se traditat jetësore të ruajtura mes malesh po shuhen?
- (A) Votra
 (B) Lahuta
 (C) Gjarpni
 (D) Nipat
21. Në cilin nga vargjet autori e shpreh fuqinë e këngës së lahutarit, duke kënduar rapsodi të këngëve të kreshnikëve?
- (A) Lahuta pushon në tym/e dorca e saj e thyeme
 (B) Lahuta pushon në trá/pse mixha ka vdekë ka mot
 (C) Por kumti i lahutës i trashë, burmuer/duket se ndihet ke votra përsëri
 (D) Treqind çika nën shatorr in kânë/Njaj mâ t'mirës djali syt s'ia dán
22. Mbi cilat figura të fjalës krijohen vargjet:
 "Lahuta pushon në tym
 e dorca e saj e thyeme
 si gishtat e mixhës në vorr"
- (A) të personifikimit dhe krahasimit
 (B) të alegorisë dhe epitetit
 (C) të hiperbolës dhe metaforës
 (D) të paradoksit dhe oksimoronit

23. Çfarë rime ka katërvargëshi i poezisë?
“Lahuta pushon në trá
pse mixha ka vdekë ka mot
e nipat s’ dijnë me i rá
Lahuta pushon në tym”
- (A) ACBB
 (B) ABAC
 (C) ABBC
 (D) ACAA
24. Kjo poezi është shkruar në variant të ndryshëm nga shqipja standarde. Cilit dialekt a të folme i përket ky fragment?
- (A) Arbërisht
 (B) Arbënisht
 (C) Gegërisht
 (D) Toskërisht
25. Fjala “**burrner**” ka një tipar fonetik dialektor, që në shqipen standarde ka bërë që kjo fjalë të shkruhet “**burrëror**”. Çfarë fenomeni i është nënshtuar fjala?
- (A) rotacizëm
 (B) palatalizim
 (C) diftongim
 (D) nazalitet

I - Read the following text carefully and answer questions 26 -30:

The Golden Gate Bridge in San Francisco is really orange, not gold. It gets its name from the bit of water between the San Francisco Bay and the Pacific Ocean, called the Golden Gate. The bridge is nearly three kilometres long. For a long time, it was the longest 1) _____ bridge in the world. In the USA in the 1930s there were a lot of people without jobs. President Roosevelt wanted to give work to them. The Golden Gate Bridge was one answer to the problem. Work on the bridge began on January 5th 1933. The designers were Charles Ellis, Joseph Strauss and Irving Morrow. It took 25 million hours to build the bridge so there was work for a lot of people. It cost \$35 million dollars. Work on the bridge finished on April 19th 1937. On May 27th 1937, the bridge opened for the first time and 200,000 people walked, climbed, skated or cycled across it. The next day it opened for traffic.



26. The origin of the name of Golden Gate comes from the _____.
- (A) locals
(B) water
(C) gold
(D) shape
27. What was the main purpose behind building the Golden Gate Bridge?
- (A) To design a skating track
(B) To allow people to walk across it
(C) To lower the high rate of unemployment
(D) To enable young people to cycle across it
28. Which word best fits the gap 1 in the text?
- (A) iron-made
(B) metallic
(C) seaside
(D) suspension
29. The word ***finished*** used in the text is closest in meaning to _____.
- (A) suspended
(B) continued
(C) completed
(D) interrupted
30. Which title best fits the text?
- (A) A bridge that never opened to the public
(B) A bridge that united people of America
(C) A bridge that broke just after its construction
(D) A bridge built in the right place and time

II - Read the following text carefully and answer questions 31 - 36:

- I. Although I work in the centre of London now, I like going to the mountains when I can. Last winter I decided to spend a week in Scotland. I wanted to go skiing and walking in the mountains. I looked on the internet and 2) _____ a cottage for a week. So, I packed my bags, went to the airport, and waited to get on the plane.
- II. Then the problems started. The plane didn't leave that night. There was a lot of snow in Scotland and the airports closed. So, I spent the night at the airport drinking tea and reading the news. I tried to sleep but I wasn't comfortable. Next morning, the airport opened again, and we arrived in Scotland, but my bags weren't there.
- III. I hired a car and drove to the cottage. It was a twenty-minute drive from the airport. When I arrived, there was a family with two little children in the cottage! They booked on the internet, too - for the same week. The family was very kind. They said I could sleep in the lounge, and they cooked dinner for me.
- IV. Next day, I got my bags from the airport and decided to go skiing. But the mountain road was blocked due to snow. I didn't ski and I didn't go walking in the mountains. I spent the week in the cottage waiting to go home - it wasn't my favourite holiday!

31. Which of the following titles best suits the text?

- A A disastrous holiday
 B A favourite holiday
 C A well-planned holiday
 D A winter holiday

32. Which word best fills the gap number 2 in paragraph one?

- A hired
 B bought
 C paid
 D booked

33. Which statement in paragraph one is **NOT** true about the writer?

- A The writer found his/her holidays online.
 B The writer extremely likes Scottish mountains.
 C The writer works in the suburb of London.
 D The writer prefers skiing and walking in mountains.

34. Which statement in paragraph two is true about the writer staying at the airport?

- A The writer slept in the airport hotel comfortably.
 B The writer spent the time reading and having tea.
 C The writer spent the time walking around the airport.
 D The writer spent time window shopping at the airport.

35. According to paragraph three, which statement is true about the cottage?

- A The cottage was very close to the seashore.
 B The cottage was too expensive for a short stay.
 C The cottage was extremely comfortable for a holiday.
 D The cottage was rented to two different clients.

36. According to paragraph four, the writer _____.
- (A) spent almost all of his/her holiday skiing and walking
 - (B) enjoyed his/her holiday playing with the children
 - (C) his/her holiday wasn't pleasant due to the weather
 - (D) spent all of his/her holiday enjoying the landscape

III - Read the following text carefully and answer questions 37 - 43:

- I. This week in Inventor's World, we asked one reader, Ben Cross, aged 25, to tell us which inventions he thinks have changed our lives the most. Which inventions did he choose? Do you agree with him?
- II. I work in IT, so I have a close relationship with electrical gadgets! In my opinion, one recent invention that has changed our lives is the laptop computer. It allows us to work anywhere, and has made our working lives so much easier. The idea for the first laptop (or portable computer) was created by Alan Kay in 1968. Kay wanted to make a personal computer for children to learn computer skills. It was known as the Dynabook. In fact, the Dynabook was never built. But his idea was used by other companies to develop laptops and PCs.
- III. The first portable computer in the shops was made by Osborne Computer Corporation in 1981. It was called Osborne 1. I'm too young to remember all this, but my boss told me that the first laptops were very heavy and difficult to carry around. I can't imagine life without my laptop. What did people use to do before they were invented?
- IV. It's clear to me that another invention that has changed all our lives is the electric light bulb. We can go out or work late in the evening and through the night, if we want to. These extra hours mean that we can do more and be more successful. What would we do if we couldn't go out in the evenings because it was too dark to see?
- V. The light bulb wasn't invented recently - it was invented in 1879 by Thomas Edison - but I can't think of another invention that has made such a difference to our lives. The early glass light bulbs were made by hand. Later they were produced by machine, and became cheaper to buy. These days, light bulbs are made in a variety of different types and sizes. They are used in the home, at work, in cars, in torches, on Christmas trees, and so on. Life would be very dark without them.
37. What is the best title for this text?
- (A) Life in Miami
 - (B) The greatest inventions of the world
 - (C) The manufacture of automobiles
 - (D) Movies that changed the world
38. The text provides important details about _____.
- (A) the innovative ideas that changed the world
 - (B) three major plane factories in the world
 - (C) indigenous people in Americas
 - (D) the best school systems in the world
39. According to paragraph five, the light bulbs are _____ nowadays than they used to be at the time when they were made.
- (A) more bluish
 - (B) more affordable
 - (C) less reddish
 - (D) less affordable

40. According to paragraph two, the first personal computer, known as *Dynabook*, was _____.
- (A) never constructed
 (B) sold over the world
 (C) allowed to be used in schools
 (D) more expensive than expected
41. The main purpose of the inventor to create a laptop was to _____.
- (A) make the teachers' job easier
 (B) help himself with his daily works
 (C) enable children to learn computer skills
 (D) provide communication channels for people of that era
42. The invention of light bulbs it possible for people to _____.
- (A) be more willing to work in the morning and rest at night
 (B) work for longer hours and be more productive at work
 (C) be more relaxed when working late at night
 (D) buy things at a cheaper price and save money
43. According to paragraph five the process of producing light bulbs _____.
- (A) became more modern
 (B) became more difficult
 (C) changed only a bit
 (D) remained the same

IV - Read the following text carefully and answer questions number 44 - 50:

I. The Sun today is a yellow dwarf star. It has existed in its present state for about 4 billion, 600 million years and is thousands of times larger than the Earth. The Sun is fuelled by thermonuclear reactions near its centre that convert hydrogen to helium. They release so much energy that the sun can shine for about 10 billion years with little change in its size or brightness. This balance of forces keeps the gases of the Sun from pulling any closer together.



II. By studying other stars, astronomers can predict what the rest of the Sun's life will be like. About 5 billion years from now, the core of the Sun will shrink and become hotter. The temperature at the surface will fall. The higher temperature of the interior will increase the rate of thermonuclear reactions. The outer regions of the Sun will expand approximately 35 million miles, about the distance to Mercury, which is the closest planet to the Sun. The Sun will then be a red giant star. Temperatures on the earth will become too hot for life to exist.

III. Once the Sun has used up its thermonuclear energy as a red giant, it will begin to shrink. After it shrinks to about the size of the Earth, it will become a white dwarf star. The Sun may throw off huge amounts of gases in violent eruptions called nova explosions as it changes from a red giant to a white dwarf.

IV. After billions of years as a white dwarf, the Sun will have used up all its fuel and will have lost its heat. Such a star is called a black dwarf. After the Sun has become a black dwarf, the Earth will be dark and cold. If any atmosphere remains **there**, it will have frozen onto the Earth's surface.

44. What is the primary purpose of this text?
- (A) To alert people to the dangers posed by the sun.
 - (B) To discuss conditions on Earth in the far future.
 - (C) To present a theory about red giant stars.
 - (D) To describe changes that the Sun will go through.
45. The word ***fuelled*** in paragraph 1 is closest in meaning to _____.
- (A) powered
 - (B) bombarded
 - (C) created
 - (D) propelled
46. What does the word ***they*** in paragraph 1 refer to?
- (A) the balance of forces
 - (B) thermonuclear reactions
 - (C) thousands of times
 - (D) 600 million years
47. It can be inferred from the text that the Sun _____.
- (A) is approximately halfway through its life as a yellow dwarf
 - (B) has been in existence for 10 billion years
 - (C) is rapidly changing in size and brightness
 - (D) will continue as a yellow dwarf for another 10 billion years
48. According to the passage, which of the following best describes the sequence of stages that the Sun will probably pass through?
- (A) Yellow dwarf, white dwarf, red giant, black giant
 - (B) Red giant, white dwarf, black dwarf, nova explosion
 - (C) Yellow dwarf, red giant, white dwarf, black dwarf
 - (D) White giant, red giant, black dwarf, yellow dwarf
49. What does the word ***there*** in the last line refer to?
- (A) the Sun
 - (B) the Earth
 - (C) Venus
 - (D) Mercury
50. Which of the following best describes the tone of the text?
- (A) objective
 - (B) alarmed
 - (C) comic
 - (D) pessimistic

51. Nëse $x + 3$ është numër çift, cili nga numrat vijues është numër tek?

- (A) $2x + 5$
- (B) $2x - 2$
- (C) $x - 3$
- (D) $3x + 1$

52. Baza e një trekëndëshi është për 5 cm më e madhe se lartësia e tij. Shuma e bazës dhe lartësisë së atij trekëndëshi është së paku 32 cm. Cili nga inekuacionet vijuese e paraqet këtë situatë?

- (A) $a + (a + 5) \leq 32$
- (B) $a - (a + 5) \leq 32$
- (C) $a + (a + 5) \geq 32$
- (D) $a \cdot (a + 5) \geq 32$

53. Nëse $a + 2b = 5$ dhe $c = 3$, sa është $a + 2\left(b - \frac{1}{2} + \frac{1}{6}c\right)$?

- (A) 4
- (B) 5
- (C) $\frac{1}{3}$
- (D) $\frac{1}{6}$

54. Një nxënës ka blerë disa fletore dhe dy lapsa. Një fletore kushton 1,20 euro, kurse një laps kushton 0,50 euro. Me cilin nga funksionet vijuese caktohet çmimi i përgjithshëm për blerjen e fletoreve dhe lapsave?

- (A) $y = 0,2x + 1$
- (B) $y = x + 2$
- (C) $y = 1,2x + 1$
- (D) $y = 0,5x + 1$

55. Të thjeshtohet shprehja $\frac{x^2 - 4x + 4}{x^3 - 8} : \frac{1}{x^2 + 2x + 4}, x \neq 2$


- (A) $x - 2$
- (B) $x + 2$
- (C) $x - 4$
- (D) $x + 4$

56. Numrat -1 dhe 3 janë zero të një funksioni kuadratik $f(x) = ax^2 + bx + 1, a \neq 0$. Sa është $f(-3)$?

- (A) -16
- (B) -4
- (C) 0
- (D) 12

57. Janë dhënë tre hapa të ndërtimit të një modeli. Cila shprehje paraqet hapin e n -të modelit?

- (A) $4n + 1$
- (B) $6n - 1$
- (C) $3n + 2$
- (D) $n + 4$



58. Një kuti përmban sfera të verdha dhe të kuqe. Raporti i sferave të kuqe ndaj sferave të verdha është 7 me 5. Një sferë e nxjerrim nga kutia në mënyrë të rastësishme. Sa është probabiliteti që sfera e nxjerrë nga kutia të jetë e kuqe?


- (A) $\frac{5}{7}$
- (B) $\frac{5}{12}$
- (C) $\frac{7}{12}$
- (D) $\frac{1}{2}$

59. Cili është ekuacioni i drejtëzës që kalon nëpër pikën $P(2,5)$ dhe është paralele me boshtin Ox ?

- (A) $y = 2$
- (B) $y = 5$
- (C) $y = 5 - x$
- (D) $y = 2 - x$

60. Pikat $A(-3,-2)$ dhe $B(5,2)$ të rrethit të dhënë në figurën vijuese, i takojnë një diametri të tij. Cili është ekuacioni i atij rrethi?

- (A) $(x - 1)^2 + y^2 = 20$
- (B) $(x + 1)^2 + y^2 = 20$
- (C) $x^2 + (y - 1)^2 = 20$
- (D) $x^2 + (y + 1)^2 = 20$



61. Caktoni numrin kompleks $z = x + iy$ që plotëson kushtin $(2 + i) \cdot z = 1 + 3i$.


- (A) $z = 1 - i$
- (B) $z = 2 + i$
- (C) $z = 1 + 2 \cdot i$
- (D) $z = 1 + i$

62. Është dhënë termi i përgjithshëm i një vargu $a_n = 5 - 2n$ për $n \geq 1$. Cili pohim është i saktë?

- (A) Është varg aritmetik me diferencë $d = -2$
- (B) Është varg aritmetik me diferencë $d = 2$
- (C) Është varg gjeometrik me herës $q = \frac{1}{2}$
- (D) Është varg gjeometrik me herës $q = -\frac{1}{2}$

63. Në figurë janë dhënë grafikët e katër funksioneve eksponenciale. Cili grafik i përgjigjet funksionit eksponencial $f(x) = 3^x - 1$?

- (A) y_1
- (B) y_2
- (C) y_3
- (D) y_4



64. Një koloni e baktereve e dyfishon popullacionin e saj çdo 15 orë. Shkencëtarët e kryejnë një eksperiment duke filluar me 100 baktere të tilla. Cili nga funksionet vijuese eksponenciale e paraqet numrin $N(t)$ të baktereve, që pritet të bëhen pas t orësh?

- (A) $N(t) = 100 \cdot 2^{15t}$
- (B) $N(t) = 100 \cdot 2^{\frac{t}{15}}$
- (C) $N(t) = 15 \cdot 2^{100t}$
- (D) $N(t) = 15 \cdot 2^{\frac{t}{100}}$

65. Cili është kulmi i funksionit kuadratik $y = 3x^2 + 12x + 8$?


- (A) $K(2,4)$
- (B) $K(-2,4)$
- (C) $K(2,-4)$
- (D) $K(-2,-4)$

66. Janë dhënë vektorët $\vec{a} = \vec{i} + 2\vec{j}$, $\vec{b} = 2\vec{i} - \vec{j}$ dhe $\vec{c} = -3\vec{i} + 4\vec{j}$. Sa është vlera e parametrit k ashtu që të vlejë $\vec{a} + k\vec{b} = \vec{c}$?

- (A) -2
- (B) -1
- (C) 1
- (D) 2

67. Të caktohet gjatësia TP nga të dhënat në figurë, nëse $PQ \parallel RS$.

- (A) 18
- (B) 20
- (C) 22
- (D) 25



68. Figura tregon bashkësinë e të gjithë numrave realë të cilët plotësojnë jobarazimin $|x - 4| \leq 5$. Sa është vlera e k -së?

- (A) 1
- (B) 4
- (C) 5
- (D) 9




69. Nëse $a = \sin 80^\circ$, $b = \cos 80^\circ$ dhe $c = \cos 100^\circ$, cila nga jobarazitë vijuese është e saktë?

- (A) $a < b < c$
- (B) $c < b < a$
- (C) $a < c < b$
- (D) $b < c < a$

70. Në situatën si në figurën vijuese, të caktohet distanca AB ?

- (A) 15 m
- (B) 18 m
- (C) 21 m
- (D) 24 m




71. Le të jetë x numër natyror. Mediana e numrave $1 + x, 2 + 5x, 2 + 3x, 1, 1 + 3x$ është e barabartë me 19. Sa është vlera e x -it?

- (A) 6
(B) 3
(C) 4
(D) 2

72. Sa është përafërsisht lartësia e një rezervuari të ujit në formë cilindrike me diametër 6 dm, e që zë 270 litra ujë?

- (A) 7,4 dm
(B) 8,5 dm
(C) 9,6 dm
(D) 10,7 dm



73. Një regjistër i numrave të telefonave përmban 100 numra të ndryshëm telefonash. Frekuenca e paraqitjes së shifrave 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 si shifër e fundit e atyre numrave të telefonit është dhënë në tabelën vijuese:

Shifra	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Frekuenca e paraqitjes	7	6	12	7	10	10	14	13	11	10

Sa është probabiliteti që një numër telefoni i zgjedhur rastësisht nga ai regjistër, të ketë shifrën e fundit numër të plotpjesëtueshëm me 3?

- (A) 0,28
(B) 0,31
(C) 0,35
(D) 0,38

74. Sa është $\lim_{x \rightarrow 1} \frac{x-1}{3x^2-3}$?

- (A) 0
(B) $\frac{1}{3}$
(C) $\frac{1}{6}$
(D) 1

75. Sa është derivati i funksionit $f(x) = \frac{x}{2x+1}$ në pikën $x_0 = -1$?


- (A) -1
(B) $-\frac{1}{4}$
(C) $\frac{1}{4}$
(D) 1

51. Një nxënës ka blerë disa fletore dhe dy lapsa. Një fletore kushton 1,20 euro, kurse një laps kushton 0,50 euro. Me cilin nga funksionet vijuese caktohet çmimi i përgjithshëm për blerjen e fletoreve dhe lapsave?
- (A) $y = 1,2x + 1$
 (B) $y = 0,5x + 1$
 (C) $y = x + 2$
 (D) $y = 0,2x + 1$
52. Cili është ekuacioni i drejtëzës që kalon nëpër pikën $P(2,5)$ dhe është paralele me boshtin Ox ?
- (A) $y = 2 - x$
 (B) $y = 5 - x$
 (C) $y = 5$
 (D) $y = 2$
53. Është dhënë termi i përgjithshëm i një vargu $a_n = 5 - 2n$ për $n \geq 1$. Cili pohim është i saktë?
- (A) Është varg gjeometrik me herës $q = \frac{1}{2}$
 (B) Është varg aritmetik me diferencë $d = -2$
 (C) Është varg aritmetik me diferencë $d = 2$
 (D) Është varg gjeometrik me herës $q = -\frac{1}{2}$
54. Një koloni e baktereve e dyfishon popullacionin e saj çdo 15 orë. Shkencëtarët e kryejnë një eksperiment duke filluar me 100 baktere të tilla. Cili nga funksionet vijuese eksponenciale e paraqet numrin $N(t)$ të baktereve, që pritet të bëhen pas t orësh?
- (A) $N(t) = 15 \cdot 2^{\frac{t}{100}}$
 (B) $N(t) = 100 \cdot 2^{15t}$
 (C) $N(t) = 100 \cdot 2^{\frac{t}{15}}$
 (D) $N(t) = 15 \cdot 2^{100t}$
55. Cili është kulmi i funksionit kuadratik $y = 3x^2 + 12x + 8$?
- (A) $K(-2,-4)$
 (B) $K(-2,4)$
 (C) $K(2,4)$
 (D) $K(2,-4)$
56. Nëse $a = \sin 80^\circ$, $b = \cos 80^\circ$ dhe $c = \cos 100^\circ$, cila nga jobarazitë vijuese është e saktë?
- (A) $a < b < c$
 (B) $c < b < a$
 (C) $a < c < b$
 (D) $b < c < a$

57. Cilët numra përdoren për matjen më të saktë të temperaturës së pacientëve në një spital?
- (A) Numrat natyral
 (B) Numrat iracional
 (C) Numrat e plotë
 (D) Numrat racional
58. Është dhënë bashkësia $A = \{x \in \mathbb{N} : 2 < x < 18\}$. Sa elemente x nga bashkësia A janë të tillë që $2^x \in A$?
- (A) 4
 (B) 3
 (C) 2
 (D) 1
59. Cila shprehje paraqet polinom?
- (A) $x^4 - 2x^{-2} + \frac{1}{2}$
 (B) $\frac{x^5 - x^3 + 3}{5}$
 (C) $-2\sqrt{x}$
 (D) $4^x - 3^x + 2^x - 1$
60. Për një vend pune kanë konkuruar (aplikuar) 8 persona të cilët i kanë plotësuar të gjitha kushtet e konkursit. Në sa mënyra mund t'i zgjidhni 5 prej tyre?
- (A) 56
 (B) 12
 (C) 72
 (D) 40
61. Cila nga shprehjet e dhëna **nuk** është e barabartë me $\frac{1}{9}$?
- (A) $3^{-2} \cdot 3^0$
 (B) $3 \cdot 3^{-3}$
 (C) 9^{-1}
 (D) 9^{-2}
62. Sa është vlera e determinantës (përcaktorit) $\begin{vmatrix} 2 & 1 \\ -i & 3 \end{vmatrix}$?
- (A) $6 + i$
 (B) $6 - i$
 (C) $6 - 2i$
 (D) $6 + 2i$

63. Në figurë janë dhënë grafikët e katër funksioneve eksponenciale. Cili grafik i përgjigjet funksionit eksponencial $f(x) = 3^x - 1$?

- (A) y_1
 (B) y_2
 (C) y_3
 (D) y_4



64. Cila nga vlerat e dhëna është zgjidhje e ekuacionit eksponencial $3^{x-1} - \frac{1}{81} = 0$?

- (A) 1
 (B) -3
 (C) -4
 (D) 0

65. Sa është vlera e shprehjes $\log \sqrt{25} + \log \sqrt{4} - 2 \cdot \log 5$?

- (A) $\log \left(\frac{5}{2} \right)$
 (B) 5
 (C) 2
 (D) $\log \left(\frac{2}{5} \right)$

66. Termi i parë dhe i tetëmbëdhjetë i vargut aritmetik është 7 dhe 58. Sa është diferenca e tij?

- (A) 3
 (B) 2
 (C) 1
 (D) 4

67. Sa është vlera e limitit $\lim_{x \rightarrow -2} \frac{8x - 2x^3}{x + 2}$?


- (A) 16
- (B) -16
- (C) -4
- (D) 4

68. Sa është derivati i funksionit $f(x) = 5x - 32\sqrt{x}$ në pikën $x = 4$?

- (A) -4
- (B) 24
- (C) 20
- (D) -3

69. Sa është syprina e sipërfaqes së figurës së dhënë?

- (A) 130 njësi katrore
- (B) 150 njësi katrore
- (C) 115 njësi katrore
- (D) 185 njësi katrore




70. Vëllimi i një kubi është 8cm^3 . Sa është syprina e sipërfaqes së tij?


- (A) 4cm^2
- (B) 16cm^2
- (C) 24cm^2
- (D) 48cm^2

71. Sa është vëllimi i trupit të dhënë në figurë?

- (A) $15.5 \pi \text{ m}^3$
- (B) $17.5 \pi \text{ m}^3$
- (C) $16.5 \pi \text{ m}^3$
- (D) $14.5 \pi \text{ m}^3$



72. Janë dhënë vektorët \vec{a} dhe \vec{b} si në figurë



Cili vektor i paraqitur në figurën në vazhdim është vektori $2\vec{a} + \vec{b}$?

- (A)
- (B)
- (C)
- (D)

73. Cila pikë është qendra e rrethit të dhënë me ekuacionin e tij $(x - 2)^2 + (y + 4)^2 = 9$?

- (A) Pika $Q(4,9)$
- (B) Pika $Q(-3,3)$
- (C) Pika $Q(-2,3)$
- (D) Pika $Q(2,-4)$

74. Biletat e shitura në teatrin e një qyteti për 13 ditë me radhë janë:


4	2	5	8	6	6	
4	3	2	4	7	8	5

Sa është mediana e tyre?

- (A) 2
- (B) 4
- (C) 5
- (D) 8

75. Supozojmë se figura e dhënë paraqet një objekt për ta qëlluar me shigjetë. Rrethi i dhënë e ka rrezën me gjatësi 6 njësi dhe po ashtu katrori e ka brinjën me gjatësi 6 njësi. Sa është gjasa (probabiliteti) që të qëllohet me shigjetë brenda katrorit (mundësia që të qëllohet jashtë rrethit përjashtohet)?

- (A) $\frac{1}{36}$
- (B) 6
- (C) π
- (D) $\frac{1}{\pi}$



76. Me cilën nga formulat vijuese llogaritet rruga të lëvizja drejtvizore me nxitim konstant?


- (A) $s = v_0 + \frac{1}{2}at$
- (B) $s = v_0 + \frac{1}{2}at^2$
- (C) $s = v_0 + \frac{1}{2}ta$
- (D) $s = v_0 + \frac{1}{2}a^2t$

77. Cili nga pohimet është i saktë për ligjin e tretë të Njutonit?

- (A) Veprimet e dy trupave në njëri-tjetrin janë të barabarta dhe me kahe të kundërta
- (B) Veprimet e dy trupave në njëri-tjetrin nuk janë të barabarta dhe me kahe të njëjta
- (C) Veprimet e dy trupave në njëri-tjetrin nuk janë të barabarta dhe me kahe të kundërta
- (D) Veprimet e dy trupave në njëri-tjetrin janë të barabarta dhe me kahe të njëjta

78. Drini për të zhvendosur një pako për $d = 8m$ nga vendi ku ndodhet ai përdori forcën prej $F = 50N$. Sa punë (A) ka kryer Drini gjatë zhvendosjes së pakos për këtë distancë?


- (A) $A = 6.25J$
- (B) $A = 42J$
- (C) $A = 58J$
- (D) $A = 400J$



79. Në figurë është paraqitur ena e mbyllur me piston dhe e mbushur me gaz, ku me rritjen e temperaturës rritet shtypja e gazit kurse vëllimi vazhdimisht mbetet konstant.


Cili ligj i gazit ideal e shpjegon dukurinë kur vëllimi mbetet vazhdimisht konstant?

- (A) Ligji i Bojl-Mariotit
- (B) Ligji i Gej-Lysakut
- (C) Ligji i Sharlit
- (D) Ligji i Avogadros



80. Si është marrëdhënia e këndit të rënies (α) me atë të reflektimit (β) kur vala zanore bie në sipërfaqe të ujit si në figurë?

- (A) $\alpha > \beta$
- (B) $\alpha < \beta$
- (C) $\alpha = \gamma$
- (D) $\alpha = \beta$




81. Ligji i rezistencës elektrike paraqitet me formulën $R = \rho \frac{l}{S}$, ku ρ varet nga lloji i materialit dhe paraqet rezistencën specifike. Cila është formula që shpreh rezistencën specifike të materialit?

- (A) $\rho = R \frac{l}{S}$
 (B) $\rho = S \frac{l}{R}$
 (C) $\rho = R \frac{S}{l}$
 (D) $\rho = RSl$

82. Çka ndodh ndërmjet dy përcjellësve paralelë nëpër të cilët rrjedhë rryma elektrike me kahe të njëjta?


- (A) Tërhiqen ndërmjet veti
 (B) Refuzohen ndërmjet veti
 (C) Edhe tërhiqen edhe refuzohen ndërmjet veti
 (D) As nuk tërhiqen e as nuk refuzohen ndërmjet veti



83. Në figurë është paraqitur objekti me lartësi P - Q në largësi të caktuar nga pasqyra konkave ku pas reflektimit paraqitet shëmbëllimi i tij P' - Q'.

Çfarë shëmbëllimi është paraqitur në këtë pasqyrë?

- (A) Real i drejtë dhe i zmadhuar
 (B) Real i pëmbysur dhe i zvogëluar
 (C) Virtual i drejtë dhe i zmadhuar
 (D) Virtual i pëmbysur dhe i zvogëluar




84. Kur elektroni kalon nga niveli më i lartë energjetik në një nivel më të ulët emitohet një kuant i energjisë. Me cilën nga formulat llogaritet energjia e një kuanti elektromagnetik?

- (A) $E = h \cdot \lambda$
 (B) $E = h \cdot \frac{\lambda}{c}$
 (C) $E = h \cdot \frac{c}{\lambda}$
 (D) $E = h \cdot \lambda \cdot c$


85. Në figurë është paraqitur lëvizja e tokës rreth diellit. Cila nga pozitat e tokës ndaj diellit paraqet perihelin?

- (A) 1
- (B) 2
- (C) 3
- (D) 4




86. Me çfarë shpejtësie nget automobilin Zani, nëse rruga e kaluar e automobilit në njësi të kohës është si në grafik?

- (A) $v = 2 \frac{m}{s}$
- (B) $v = 3 \frac{m}{s}$
- (C) $v = 1 \frac{m}{s}$
- (D) $v = 0.5 \frac{m}{s}$




87. Dy sfera me masa të ndryshme lëvizin me shpejtësi të njëjtë. Për sa herë sfera e parë (I) e ka momentin e sasisë së lëvizjes më të madh se sa sfera e dytë (II) nëse masa e saj është për dy herë më e madhe se sa masa e sferës së dytë (shih figurën)?

- (A) $\sqrt{2}$ herë
- (B) $\frac{1}{2}$ herë
- (C) 2 herë
- (D) 4 herë



88. Në cilat nga pozitat energjia potenciale e makinës lodër është maksimale, nëse trajektorja nëpër të cilën lëviz ajo është si në figurë?

- (A) 1 dhe 2
- (B) 1 dhe 3
- (C) 2 dhe 3
- (D) 2 dhe 4



89. Ylli dhe Yllka gjenden në vende të ndryshme të globit tokësor. Në vendin ku gjendet Ylli temperatura e mjedisit është $t = 30^\circ\text{C}$, ndërsa në vendin ku gjendet Yllka temperatura e mjedisit është 300K . Për sa gradë celsius temperatura e mjedisit ku gjendet Ylli është më e lartë se në mjedisin ku gjendet Yllka?


- (A) $t = 300^\circ\text{C}$
- (B) $t = 30^\circ\text{C}$
- (C) $t = 3^\circ\text{C}$
- (D) $t = 0.3^\circ\text{C}$

90. Për sa herë rritet perioda e lavjerrësit matematik, nëse gjatësia e tij rritet për 4 herë?

- (A) $\frac{1}{4}$ herë
- (B) $\frac{1}{2}$ herë
- (C) 4 herë
- (D) 2 herë


91. Në figurë është paraqitur shtegu i vrapimit të një atleti. Sa është zhvendosja e atletit në lindje nga starti në finish?

- (A) 800 m në veri
- (B) 1400 m në jug
- (C) 1800 m në lindje
- (D) 2000 m në perëndim




92. Si është marrëdhënia e shpejtësive $\frac{v_2}{v_1}$ të rrjedhjes së fluidit, nëse rrezet e seksionit të sipërfaqeve të tërthorta të tubit si në figurë janë: $r_1 = 10mm$ dhe $r_2 = 2mm$?

- (A) $\frac{v_2}{v_1} = 25$
- (B) $\frac{v_2}{v_1} = 5$
- (C) $\frac{v_2}{v_1} = 0.2$
- (D) $\frac{v_2}{v_1} = 0.04$




93. Sa është intensiteti i rrymës I_4 , nëse intensitetet e rrymave në degëzimin si në figurë janë: $I_1 = 2A$, $I_2 = 1A$ dhe $I_3 = 5A$?

- (A) $I_4 = 1A$
- (B) $I_4 = 2A$
- (C) $I_4 = 3A$
- (D) $I_4 = 4A$



94. Në figurë është paraqitur një tel me gjatësi $l=30cm$ i cili kalon nëpër një fushë magnetike. Sa është forca e Amperit në këtë tel nëpër të cilin rrjedh rryma prej $I=1A$ që është vendosur normal në fushën magnetike prej $B=30mT$?

- (A) $F = 0.1 mN$
- (B) $F = 0.9 mN$
- (C) $F = 9 mN$
- (D) $F = 90 mN$




95. Një objekt është i larguar për $a = 40cm$ nga qendra e thjerrës përmblledhëse. Në çfarë largësie nga thjerra do të paraqitet shëmbëllimi real i objektit, nëse largësia e vatrës së thjerrës është $f = 15cm$?

- (A) $b = 6cm$
- (B) $b = 10cm$
- (C) $b = 12cm$
- (D) $b = 24cm$


96. Cili eklips i trupit qiellor është paraqitur në figurë?

- (A) Hënës
- (B) Hënës dhe Diellit
- (C) Tokës dhe Hënës
- (D) Tokës




97. Sa është forca me të cilën tavolina e kundërshton trupin me masë $m = 100\text{kg}$ të vendosur mbi tavolinë nëse nxitimi i gravitetit është $g = 9.8 \frac{m}{s}$?

- (A) $F = Q = 98N$
- (B) $F = Q = 100N$
- (C) $F = Q = 490N$
- (D) $F = Q = 980N$



98. Sa është energjia potenciale e topit të basketbollit në lartësinë $h/2$, i cili nga dyshemeja hedhet në lartësi me energji kinetike $E_k = 5J$?

- (A) $E_p(h/2) = 10J$
- (B) $E_p(h/2) = 5J$
- (C) $E_p(h/2) = 2.5J$
- (D) $E_p(h/2) = 0.4J$



99. Drita mori dy portokaj të njëjtë dhe i vendosi në një gotë të mbushur me ujë. Njërin portokall e qëroi, ndërsa tjetrin nuk e qëroi. Kur ajo i vendosi portokajtë mbi sipërfaqe të ujit në gotë, vërejtë se: portokalli i qëruar u fundosë përderisa ai i pa qëruar qëndroi mbi sipërfaqe të ujit.


Pse portokalli i qëruar u fundosë në gotë?

- (A) Sepse kur qërohet portokalli sipërfaqja i bëhet më e vrazhdë
- (B) Sepse kur qërohet portokalli nuk thith ujë dhe është më i lehtë
- (C) Sepse kur qërohet portokalli bëhet më i lehtë prandaj edhe fundoset
- (D) Sepse kur qërohet portokalli ai mund të thith ujë, bëhet më i rëndë dhe kështu fundoset



100. Një qark elektrik përmban një bateri, tre llamba dhe një çelës të hapur siç paraqitet në figurë. Kur çelësi N është i hapur në cilën prej llambave rrjedhë rryma elektrike?

- (A) Në llambën 1
- (B) Në llambat 2 dhe 3
- (C) Në llambën 2
- (D) Në llambat 1 dhe 3



76. Në figurë është paraqitur cikli e ujit në natyrë dhe transformimi i tij nga një gjendje agregate në tjetrën. Si quhet procesi i kalimit të ujit nga gjendja agregate e gaztë në gjendjen e lëngët?

- (A) Avullim
- (B) Shkrirje
- (C) Kondenzim
- (D) Sublimim



77. Driloni gjatë orës praktike të kimitë ka vendosur në një gotë me sheqer të zakonshëm një sasi të acidit sulfurik, me ç'rast sheqeri dehidratohet duke prodhuar karbon dhe ujë. Në cilin grup të substancave kimike bën pjesë sheqeri i zakonshëm?

- (A) Substanca të thjeshta
- (B) Substanca të përbëra
- (C) Përzierje homogjene
- (D) Përzierje heterogjene

78. Konfiguracioni elektronik i një elementi paraqet vendosjen e elektroneve nëpër orbitale atomike. Cili nga konfiguracionet e mëposhtme i përgjigjet konfiguracionit të natriumit ${}_{11}\text{Na}$?

- (A) $[\text{He}] 5s^1$
- (B) $[\text{Ar}] 4s^1$
- (C) $[\text{Ne}] 3s^1$
- (D) $[\text{Kr}] 2s^1$

79. Bakri zakonisht gjendet në enët e gatimit, stoli, çezma, instrumentet prej bronzi, dorezat e derës dhe pajisjet shtëpiake. Sa është numri i atomeve të bakrit në një gotë bakri me masë 6.35 g?

- (A) $6.022 \cdot 10^{22}$ atome bakër
- (B) $6.022 \cdot 10^{23}$ atome bakër
- (C) $6.022 \cdot 10^{24}$ atome bakër
- (D) $6.022 \cdot 10^{25}$ atome bakër

$$L = 6.022 \cdot 10^{23} \text{ mol}^{-1}$$

$$A_r(\text{Cu}) = 63.5$$


80. Uji është tretësi më i përshtatshëm i molekulave polare dhe komponimeve jonike. Cili nga konstatimet e paraqitura është i saktë për molekulën e ujit?

- (A) Dy lidhjet O-H, në molekulën e ujit formojnë këndin e lidhjes 180°
- (B) Molekula e ujit ka hibridizim sp^3 dhe këndi i lidhjeve O-H është 109.5°
- (C) Vektori i momentit dipolar, në molekulën e ujit orientohet prej atomit të oksigjenit kah atomi i hidrogjenit
- (D) Momenti dipolar i molekulës së ujit është $\mu > 0 \text{ D}$, dhe paraqet shumën e vektorëve të dy lidhjeve O-H

81. Një nxënës ka vendosur në një gotë kimike një sasi të vogël të hidrosidit të natriumit dhe në enë ka zhytur termometrin me ç'rast termometri regjistroi rritjen e temperaturës së tretësirës. Çfarë lloj reaksioni është zhvilluar me tretjen e hidrosidit të natriumit në ujë?

- (A) Reaksion ekzotermik
- (B) Reaksion endotermik
- (C) Reaksion reduktimi
- (D) Reaksion neutralizimi

82. Gjatë djegies së sulfurit dhe xeheve sulfure, formohen dy okside të sulfurit (SO_2 dhe SO_3), varësisht nga sasia e oksigjenit që harxhohet, dhe kushtet e jashtme të reaksionit kimik.



Duke u bazuar në reaksionin e paraqitur më lartë, në cilin rast kahja e reaksionit shkon në anën e djathtë?

- (A) Nëse rritet temperatura e reaksionit kimik
 (B) Nëse rritet shtypja e gazeve në enë
 (C) Nëse zvogëlohet sasia e oksigjenit
 (D) Nëse shtohet katalizatori kimik
83. Barazimi kimik është mënyrë e shkurtër e paraqitjes së reaksionit kimik me formula kimike. Cili nga barazimet e mëposhtme është shkruar saktë?

- (A) $\text{H}_2 + \text{O}_2 = 2\text{H}_2\text{O}$
 (B) $\text{H}_2 + 2\text{O}_2 = 2\text{H}_2\text{O}$
 (C) $2\text{H}_2 + \text{O}_2 = 2\text{H}_2\text{O}$
 (D) $2\text{H}_2 + 2\text{O}_2 = 2\text{H}_2\text{O}$

84. Përzierja për ftohje të automobilave përgatitet duke përzier antifrizin e përqendruar me ujë. Sa është pjesëmarrja në vëllim e antifrizit në përzierjen e cila është përfituar me përzierjen e 2 litrave antifriz me 6 litra ujë?

- (A) 15 %
 (B) 25 %
 (C) 33 %
 (D) 55 %

85. Përqëndrimi i joneve hidrogjen është faktor shumë i rëndësishëm për proceset kimike dhe biokimike të cilat zhvillohen në organizmat e gjallë. Figura në vijim tregon përqëndrimin e joneve hidrogjen në verën e kuqe, lëngun e portokallit dhe në qumësht.



Verë e kuqe
 $6.25 \cdot 10^{-5} \text{ M}$




Lëng portokalli
 $3.2 \cdot 10^{-4} \text{ M}$



Qumësht
 $1.6 \cdot 10^{-7} \text{ M}$

Cili pohim përshkruan saktë këto tri produkte ushqimore?


- (A) Vera e kuqe ka aciditet më të lartë sesa lëngu i portokallit por më të ulët sesa qumështi
 (B) Vera e kuqe ka aciditet më të lartë sesa lëngu i portokallit dhe qumështi
 (C) Vera e kuqe ka aciditet më të ulët sesa lëngu i portokallit dhe qumështi
 (D) Vera e kuqe ka aciditet më të ulët sesa lëngu i portokallit por më të lartë sesa qumështi
86. Reaksionet kimike në të cilat substancat e ndryshme këmbejnë elektrone me njëra-tjetrën quhen reaksione të oksido-reduktimit.



Bazuar në reaksionin e paraqitur më lart, cila nga substancat kimike sillet si mjet (agjent) reduktues?

- (A) Amoniaku, sepse azoti reduktohet nga gjendja oksiduese (-3) deri në gjendje elementare (0)
 (B) Amoniaku, sepse azoti oksidohet nga gjendja oksiduese (-3) deri në gjendje elementare (0)
 (C) Oksidi i bakrit, sepse bakri reduktohet nga gjendja oksiduese (+2) deri në gjendje elementare (0)
 (D) Oksidi i bakrit, sepse bakri oksidohet nga gjendja oksiduese (+2) deri në gjendje elementare (0)

87. Elektroliza përdoret shumë për përfitimin e elementeve në gjendje të lirë me një pastërti shumë të madhe prej 99.99%. Litiumi përfitohet me elektrolizë të klorurit të litiumit (LiCl) të shkrirë. Cili gjysmëreaksion paraqet reduktimin e joneve Li^+ në katodë?
- (A) $\text{Li} + 1e \rightarrow \text{Li}^+$
 (B) $\text{Li} \rightarrow \text{Li}^+ + 1e^-$
 (C) $\text{Li}^+ + 1e^- \rightarrow \text{Li}$
 (D) $\text{Li}^+ \rightarrow \text{Li} + 1e$
88. Në elemente të bllokut s bëjnë pjesë: metalet alkaline, metalet alkalino-tokësore, hidrogjeni dhe heliumi. Cili nga elementet e përmendura ka energji të jonizimit më të madhe?
- (A) Litiumi
 (B) Hidrogjeni
 (C) Natriumi
 (D) Kaliumi
89. Enantiomerët janë izomerë të cilët nuk përputhen mes veti por qëndrojnë sikurse objekti dhe shëmbëllimi i tij pasqyror. Një izomer i tillë është alanina. Cili objekt i përgjigjet molekulës së alaninës?



- (A) Dora dhe shëmbëllima e saj
 (B) Karriga dhe shëmbëllima e saj
 (C) Piruni dhe shëmbëllimi i tij
 (D) Gota dhe shëmbëllima e saj
90. Korporata energjetike e Republikës së Kosovës kishte vendosur për shtrirjen e rrjetit elektrike nga qendra e qytetit deri në malet e largëta turistike të tij. Cili metal përdoret si largpërçues i rrymës elektrike?
- (A) Hekuri
 (B) Bakri
 (C) Plumbi
 (D) Alumini
91. Agoni aksidentalisht gjatë vrojtimit të reaksionit midis nitratit të kaliumit (KNO_3) dhe acidit sulfurik (H_2SO_4) kishte hedhur në këtë përzierje një monedhë 5 centëshe, me ç'rast kishte filluar lirimi i një gazi me ngjyrë kafe dhe me erë karakteristike. Cili gaz ishte liruar gjatë këtij aksidenti në laboratorin e kimisë?
- (A) Monoksidi i azotit, NO
 (B) Trioksidi i diazotit, N_2O_3
 (C) Dioksidi i azotit, NO_2
 (D) Pentaoksidi i diazotit, N_2O_5


92. Fosfori në formën e fosfateve të tretshme është i domosdoshëm për rritjen e bimëve. Dihidrogjen fosfati i kalciumit $\text{Ca}(\text{H}_2\text{PO}_4)_2$ është mjaft i tretshëm në ujë dhe shumë i përshtatshëm si pleh kimik. Sa gram fosfor përmbajnë 351 gram të këtij plehu?

$\text{Ar}(\text{Ca})=40, \text{Ar}(\text{H})=1, \text{Ar}(\text{P})=31, \text{Ar}(\text{O})=16$


- (A) 15 g
(B) 31 g
(C) 46 g
(D) 93 g

93. Një ditë në laboratorin e kimisë profesori po provonte vetitë e aluminit. Ai mori një gotë me tretësirë 1 molare të hidroksidit të natriumit dhe në të shtoi disa copëza të folies së aluminit, dhe menjëherë filluan të lirohen disa fluska gazi. Pastaj kërkoi nga nxënësit të vëzhgojnë eksperimentin dhe të përgjigjen se çka ndodh kur alumini bashkëvepron me hidroksidin e natriumit. Cila nga alternativat e dhëna është e saktë?

- (A) Gjatë këtij reaksioni menjëherë formohet oksigjeni
(B) Gjatë këtij reaksioni menjëherë formohet hidrogjeni
(C) Gjatë këtij reaksioni menjëherë formohet avulli i ujit
(D) Gjatë këtij reaksioni menjëherë formohet dioksidi i karbonit




94. Cila nga formulat strukturale paraqet formulën kimike të klor-2-propanit sipas Kekuleut?



- (A) I
(B) II
(C) III
(D) IV

95. Komponentet organike gjatë zhvillimit të reaksioneve kimike, mund të ndryshojnë grupet e tyre funksionore apo strukturën e tyre, varësisht nga lloji i reaksionit kimik. Cili lloj i reaksionit kimik paraqitet në vijim?



- (A) Reaksioni i polimerizimit
(B) Reaksioni i substituimit
(C) Reaksioni i adicionimit
(D) Reaksioni i eliminimit

96. Cila është formula kimike e një hidrokarburi të ngopur?

- (A) C_3H_{10}
 (B) C_6H_{14}
 (C) C_7H_{14}
 (D) C_8H_{16}

97. Lojërat e XXVI olimpike janë mbajtur në vitin 1996 në Atalanta, SHBA, prej datës 27 prill deri me 19 korrik. Për të mbajtur të ndezur flakën e pishtarit është përdorur një gaz, ku 0.25 mole të tij kanë masën 10.5 gram. Cili gaz është përdorur? $Ar(C)=12$, $Ar(H)=1$

- (A) Etani
 (B) Eteni
 (C) Propani
 (D) Propeni




98. Alkanet kanë konstante fizike (pikë shkrirje, pikë vlimi) të ulëta për shkak të forcave të dobëta në mes të molekulave të tyre. Cili nga katër izomerët e hidrokarburit me formulë molekulare C_8H_{18} ka pikë vlimi më të lartë?

- (A) Metil-3-heptan
 (B) Dimetil-2,3-heksan
 (C) Trimetil-2,3,4-pentan
 (D) Tetrametil-2,2,3,3-butan

99. Acidet karboksilike kanë veti acidike më të shprehura sesa komponimet e tjera organike por fortësia e tyre varet

edhe nga struktura e acidit. Zëvendësuesit me efektet e tyre elektronike gjithashtu ndikojnë në shkallën e aciditetit të acideve karboksilike. Në vijim janë paraqitur formulat strukturale për katër acide karboksilike




Cili nga këto acide karboksilike ka veti më të theksuara acidike?

- (A) I
 (B) II
 (C) III
 (D) IV

100. Sa përqind karbon ka në pirimidinë formula strukturore e së cilës është paraqitur në vazhdim? $Ar(C)=12$, $Ar(N)=14$, $Ar(H)=1$


- (A) 12 %
 (B) 26 %
 (C) 38 %
 (D) 60%



76. Si quhet proteina që merr pjesë në ndërtimin e muskujve dhe ka rol në kontraktimin e fijeve muskulore?

- (A) Mielina
- (B) Miozina
- (C) Elastina
- (D) Hemoglobina


77. Organelet qelizore kanë funksione të ndryshme në qelizë. Cili është organeli i shënuar me shkronjën X në figurë që merr pjesë në sintezën e hormoneve steroide?



- (A) Centrozomi
- (B) Peroksizomi
- (C) Retikulumi endoplazmatik granular
- (D) Retikulumi endoplazmatik agranular

78. Qelizat kanë strukturë të ndryshme në bazë të së cilës edhe klasifikohen. Cili tip i qelizës është paraqitur në këtë figurë?

- (A) Qelizë bimore
- (B) Qelizë shtazore
- (C) Qelizë prokariote
- (D) Qelizë e tharëve



79. Sara pasi bëri disa analiza në laborator, nga mjeku u diagnostikua me sëmundjen e rubeolës (fruthin gjerman). Cili patogjen e shkakton këtë sëmundje?

- (A) Bakteria
- (B) Rikecia
- (C) Protozoa
- (D) Virusi

80. Në figurë janë paraqitur molla, dardha dhe ftoi. Cilës familje u takojnë këto fruta?

- (A) Zhabinore
- (B) Kryqore
- (C) Trëndafilore
- (D) Fluturore




81. Shpendët klasifikohen në tri grupe të ndryshme. Kush bën pjesë në grupin e shpendëve vrapues?

- (A) Struci
- (B) Kolibri
- (C) Dallëndyshja
- (D) Pëllumbi

82. Radula është organ për gërryerjen e ushqimit. Cilët organizma shtazorë kanë radulë?

- (A) Shiritët
- (B) Këlbasat
- (C) Butakët
- (D) Krimbat boshtorë

83. Në figurë është paraqitur cikli jetësor i fiernave, ku ka alternim të brezit gametofit dhe sporofit.



Cila është qeliza e parë me të cilën fillon sporofiti?

- (A) Protali
- (B) Zigota
- (C) Spora
- (D) Anteridi

84. Mësimdhënësja në orën e biologjisë e ka përzgjedhur Anën për të prezantuar ciklin jetësor të misrit që është paraqitur si në figurë.


Çfarë e karakterizon këtë bimë?

- (A) Kërçelli me kambium
- (B) Degëzimi dikotomik
- (C) Fara me një kotiledon
- (D) Fara me dy kotiledone



85. Shiriti i derrat - *Tenia solium* i takon klasës Cestoda që janë parazitë të sistemit të tretjes te kurrizorët e ndryshëm përfshirë edhe njeriun. Cili është stadi i zhvillimit të parazitit me të cilin infektohet njeriu nga mishi i derrat?

- (A) Shiriti i ri
- (B) Cisticerkoidi
- (C) Larva onkosfera
- (D) Veza e fekunduar




86. Infeksionet ngjitëse që barten përmes marrëdhënieve seksuale mund të prekin këdo që ka marrëdhënie seksuale të pambrojtura me personin e infektuar. Cila nga këto sëmundje transmetohet seksualisht?

- (A) Sifilizi
- (B) Malaria
- (C) Dizenteria
- (D) Tuberkulozi

87. Dea gjatë prezantimit në orën mësimore të biologjisë ka paraqitur diagramin me të dhëna që i takojnë një procesi metabolik që zhvillohet në qelizë.

Cili proces metabolik është zhvilluar në këtë rast?

- (A) Glukogjeneza
- (B) Fermentimi laktik
- (C) Fermentimi alkoolik
- (D) Frymëmarrja aerobe



88. Materiet ushqyese nën veprimin e enzimave zbërthehen deri në përbërësit e tyre të thjeshtë. Cili nga enzimat bën zbërthimin e polipeptideve deri në aminoacide?

- (A) Lipaza
- (B) Pتيالina
- (C) Celulaza
- (D) Kemotripsina

89. Trashëgimi i grupeve të gjakut të sistemit AB0 te njeriu përcaktohet nga një gjen që ka tri alele. Çfarë është ndërveprimi i aleleve në rastin e grupit AB?

- (A) Intermediar
- (B) Kodominant
- (C) Komplementar
- (D) Dominanto-recesiv

90. Rrjedhja e informatës gjenetike kalon nëpër procesin e transkriptimit dhe translatisimit. Nëse gjatë translatisimit një molekulë e ARNi përmban kodonet 5'-ACC-AUG-UAC-AUC-3', cilat do të jenë antikodonet përkatëse?

- (A) 3'-UGG-5'; 3'-UAC-5'; 3'-AUG-5'; 3'-UAG-5'
- (B) 5'-GGT-3'; 3'-CAT-5'; 3'-GTA-5'; 3'-GAT-5'
- (C) 5'-GGU-3'; 3'-CAU-5'; 3'-GUA-5'; 3'-GAU-5'
- (D) 3'-TGG-5'; 3'-TAC-5'; 3'-ATG-5'; 3'-TAG-5'

91. Shumica e organizmave biseksual në qelizat e tyre trupore përmbajnë kariotipin diploid (dy gamitura të kromozomeve). Si quhen qelizat të cilat përmbajnë tri kromozome të një çifti të caktuar?

- (A) Triploide
- (B) Tetraploide
- (C) Trisomike
- (D) Tetrasomike

92. Në rastin e studimit të trashëgimit të dy tipareve kemi të bëjmë me kryqëzim dihibrid. Nëse te fara e bizelës aleli dominant **A**-përcakton ngjyrën e verdhë dhe aleli recesiv **a**-përcakton ngjyrën e gjelbër, derisa aleli dominant **B**-përcakton formën e rrumbullakët të farës dhe aleli recesiv **b**-përcakton formën e rrudhosur të farës, cilat raporte fenotipore të farave fitohen në gjeneratën F_1 nga kryqëzimi **Aabb x AABb**?

- (A) 2/4 të verdha - të rrumbullakëta; 2/4 të gjelbëra - të rrudhosura
- (B) 2/4 të verdha - të rrumbullakëta; 2/4 të verdha - të rrudhosura
- (C) 3/4 të verdha - të rrumbullakëta; 1/4 të gjelbëra - të rrudhosura
- (D) 2/4 të gjelbëra - të rrumbullakëta; 2/4 të verdha - të rrudhosura

93. Inxhinieringu gjenetik përfshinë metodat më të avancuara molekulare që njeriu i aplikon për manipulimin e gjenomit. Cili është qëllimi i terapisë gjenike?


- (A) Bartja e gjenit nga njeriu te gjenomi i baktereve ku shprehet në qelizën bakteriale
- (B) Sinteza e produkteve proteinike të gjeneve në laborator dhe përdorimi i tyre si terapi
- (C) Largimi i aleleve të gjenit mutant dhe mosvendosja e aleleve jomutante të atij gjeni
- (D) Trajtimi i sëmundjes përmes insertimit të gjenit normal në vend të atij me defekt

94. Një ndër provat e evolucionit mbi adaptimin e organizmave është edhe përshtatja e funksionit konform mënyrës së jetesës së tyre. Cilat nga çiftet e shënuara më poshtë paraqesin organet analoge?

- (A) Krahët e lakuriqëve dhe krahët e insekteve
- (B) Këmbët e përpame të lopës dhe këmbët e përpame të urithit
- (C) Gjymtyrët e përpame të pulës dhe gjymtyrët e përpame të balenës
- (D) Gjymtyrët e përpame të krokodilit dhe gjymtyrët e përpame të lakuriqit të natës

95. Spermatogjeneza është proces i krijimit të gameteve mashkullore. Duke u bazuar në figurë, cili nga pohimet përshkruan saktë qelizat e shënuara me shkronjën Y?


- (A) Janë diploide dhe kromozomet janë me nga një kromatid
- (B) Janë diploide dhe kromozomet janë me nga dy kromatide
- (C) Janë haploide dhe kromozomet janë me nga dy kromatide
- (D) Janë haploide dhe kromozomet janë me nga një kromatid



96. Në figurë është paraqitur formimi i fletëve embrionale gjatë gastrulimit ku të gjitha indet dhe organet kanë origjinë nga shtresat e ndryshme embrionale.


Cilat nga strukturat e mëposhtme zhvillohen nga ektoderma?

- (A) Muskujt, pankreasi, mëlçia
- (B) Qimet, puplat, thonjtë
- (C) Zemra, zorrët, skeleti
- (D) Veshkat, testiset, vezoret



97. Sistemi skeletor i siguron mbështetje organizmit dhe mundëson lëvizjen e tij. Si quhet kocka që në figurë është shënuar me numrin 1?

- (A) Radius
- (B) Sternum
- (C) Humerus
- (D) Klavikulë



98. Vitaminat janë substanca esenciale, që organizmi i njeriut duhet t'i marrë me anë të ushqimit. Çka shkakton mungesa e vitaminës B₁₂?

- (A) Aneminë
- (B) Skorbutin
- (C) Rahitisin
- (D) Terrin e pulave

99. Në figurë është paraqitur truri i njeriut si qendër kryesore që e kontrollon dhe drejton gjithë veprimtarinë e organizmit. Çka kontrollon pjesa e trurit me numër 1 ?

- (A) Ciklin e gjumit dhe zgjimit
- (B) Imagjinatën dhe intelektin
- (C) Koordinimin e lëvizjeve
- (D) Veprimtarinë e zemrës



100. Në organizëm me veprimin e hormoneve kontrollohen shumë procese si: rritja, zhvillimi dhe metabolizmi. Në foto është paraqitur një person me rritje të disbalancuar të eshtrave të fytyrës si pasojë e një çrregullimi hormonal. Ndryshimi i cilit hormon i shkakton këto çrregullime?

- (A) Shtimi i prodhimit të hormonit somatotrop
- (B) Pakësimi i prodhimit të hormonit adrenokortikotrop
- (C) Pakësimi i prodhimit të hormonit melatoninë
- (D) Shtimi i prodhimit të hormonit tireotrop




76. Hard Disku ka funksion:

- (A) Ekzekutimin e sistemit operativ
- (B) Ruajtjen e të dhënave
- (C) Ndërtimin e sinjalit të monitorit
- (D) Përpunimin e zërit në kompjuter

77. Shkolla ka blerë një TV të ri për kabinetin e TIK-ut. Profeshori i TIK-ut e lidh laptopin e tij me TV përmes portit:

- (A) DVI
- (B) USB
- (C) HDMI
- (D) HIV




78. Cilat nga opsionet e mëposhtme nuk janë Sisteme Operative:

- I. Windows
- II. C++
- III. Excel
- IV. Linux

- (A) I dhe III
- (B) II dhe III
- (C) III dhe IV
- (D) II, III dhe IV

79. Ndërveprimi dhe arkitektura e Sistemit Operativ mund të paraqitet sikurse:



80. Kompjuteri që shërben si njësi qendrore e rrjetit, ku menaxhon të gjithë kompjuterët tjerë dhe të gjitha pajisjet e lidhura në rrjet quhet:

- (A) Processor
- (B) Internet
- (C) Wireless
- (D) Server

81. Për të siguruar të dhënat tona nga qasja e paautorizuar në një nivel të sigurisë ne përdorim fjalëkalimin (password). Cili nga fjalëkalimet e listuar është më i sigurti në bazë të rregullave për krijimin e një fjalëkalimi?

- (A) 00001111
- (B) Arberi123
- (C) @rB3R!_00
- (D) 123Arb3r1

82. Në cilin grup të funksioneve bën pjesë funksioni **IF** në Excel?

- A Statistike
- B Logjike
- C Matematike
- D Tekstuale

83. Nëse qeliza **A5** në tabelën e mëposhtme përmban një funksion që rezultati i saj është **25**, atëherë cili nga funksionet në Excel është zbatuar në këtë qelizë:

- A =COUNT(A1:A4)
- B =SUM(A1:A4)
- C =MIN(A1:A4)
- D =AVERAGE(A1:A4)

	A
1	10
2	20
3	30
4	40
5	

84. Funksioni që do të shfaq numrin e karaktereve në qelizën **A1** në Excel përdoret:

- A =LEN(A1)
- B =COUNT(A1)
- C =SUM(A1)
- D =AVERAGE(A1)

85. Në Excel mund të përdoren formate të ndryshme të të dhënave. Cili format i të dhënave është përdorur për qelizat C2 deri në C6 ashtu që shënimi "kg" të paraqitet në mënyrë automatike sa herë të shkruhet numri i sasisë për artikullin e caktuar?

- A Currency
- B Accounting
- C Custom
- D Time

	A	B	C	D
1	Nr	Produkti	Sasia / kg	Çmimi
2	1	Fara luledielli	110 kg	€ 0.40
3	2	Fistek	20 kg	€ 1.00
4	3	Arra	50 kg	€ 2.20
5	4	Misër	100 kg	€ 0.30
6	5	Badem	30 kg	€ 0.90

86. Pas ekzekutimit të funksionit =AND(2*3=6, 6/2=2), rezultati në Excel do të jetë:

- A TRUE
- B 2
- C 3
- D FALSE

87. Pas ekzekutimit të funksionit =RIGHT("Gjuhë Angleze", 7), rezultati në Excel do të jetë:

- A Gjuhë Angleze
- B Gjuhë
- C Angleze
- D Gj. Angleze

88. Sipas të dhënave të tabelës së paraqitur si më poshtë, Artani pas ekzekutimit të funksionit në Excel =SUMIF (A1:D2, "<0"), rezultati që fitoi ai është:

- (A) -6
(B) 0
(C) 12
(D) 18

	A	B	C	D
1	4	1	-2	8
2	-1	3	2	-3

89. Cila nga opsionet e mëposhtme është shembulli më i mirë për menaxhimin elektronik të të dhënave të pacientëve, stafit të mjekëve dhe shërbimeve që ofron një qendër spitalore:

- (A) Një program për prezantim (PowerPoint)
(B) Një bazë e të dhënave (Access)
(C) Një program për shkrim (Word)
(D) Një program për vizatim (Paint)

90. Çfarë lidhje relacionale duhet krijuar mes tabelave "Produkti" dhe "Porosia", ku një porosi mund të përmbajë shumë produkte dhe një produkt mund të jetë pjesë e shumë porosive:

- (A) Një-me-një
(B) Një-me-shumë
(C) Pak-me-shumë
(D) Shumë-me-shumë

91. Gjatë punës në pyetësin e krijuar me të dhënat nga tabela Librat, është përdorur kriteri në fushën si në figurë. Cili është roli i shenjës së yllit (*) në kriterin e fushës Titulli në bazën e të dhënave në Access?

Field:	LibriKodi	Titulli	Autori
Table:	Librat	Librat	Librat
Sort:			
Show:	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Criteria:		Like "A*"	
or:			

- (A) Paraqiten titujt e librave që nuk kanë shkronjën A në emërtimin e tyre
(B) Zëvendëson të gjitha shkronjat që vijnë para shkronjës A në titujt e librave
(C) Zëvendëson të gjitha shkronjat që vijnë pas shkronjës A në titujt e librave
(D) Paraqiten titujt e librave, emri i autorit të të cilëve fillon me shkronjën A

92. Vjollca si punëtore në një kompani ka nevojë të shfaq të gjitha produktet e tabelës Produkti që kanë çmimin mes 50 dhe 150 euro. Cilin kriter duhet të aplikoj ajo te pyetësi i bazës së të dhënave në Access për ekzekutimin e kësaj kërkesë:

- (A) [Çmimi] >= 50 AND [Çmimi] <= 150
(B) [Çmimi] <= 50 AND [Çmimi] >= 150
(C) [Çmimi] <= 50 OR [Çmimi] >= 150
(D) [Çmimi] >= 50 NOT [Çmimi] <= 150

93. Në formularë në Access mund të vendosen butona me funksione të ndryshme. Çfarë funksioni ka butoni që shihet në figurë?

- (A) Kalimi në rekordin e fundit
- (B) Fshirja e rekordit paraparak
- (C) Kalimi në rekordin e radhës
- (D) Kalimi në rekordin e parë



94. Cili është një problem i mundshëm në PowerPoint kur përdoren shumë efekte të animacionit në sllajde?

- (A) Prezantimi mund të bëhet më me interes për audiencën
- (B) Prezantimi mund të shkaktojë mëzë të audiencës dhe të bëjë prezantimin e panevojshëm të gjatë
- (C) Prezantimi mund të shkaktojë probleme teknike në pajisjen që po përdoret për prezantim
- (D) Prezantimi mund të bëhet më argëtues për audiencën

95. Nëse një prezantim në PowerPoint ruajmë me butonin "Save As" në OneDrive. Çfarë është përfitimi në këtë rast?

- (A) Prezantimi është në cloud të OneDrive dhe mund të shpërndahet me të tjerët
- (B) Prezantimi është ruajtur me emrin OneDrive
- (C) Prezantimi është më profesional
- (D) Prezantimi është më i thjeshtë

96. Hana gjatë punës në PowerPoint shton në sllajd disa fotografi. Shihet se fotografitë nuk kanë largësi të njëjtë mes vete. Përmes cilës komandë mund të rregullohet distanca e barabartë mes fotografive?



- (A) Align Middle
- (B) Align Center
- (C) Distribute Horizontally
- (D) Distribute Vertically


97. Çfarë është një **Animation Path** në PowerPoint:

- (A) Një funksion që mundëson ndryshimin e madhësisë së një objekti që po lëviz
- (B) Një rrugë që tregon lëvizjen e elementeve në prezantim
- (C) Një animacion që tregon ndryshimin e ngjyrave të elementeve
- (D) Një meny që mundëson ndryshimin e formatit të prezantimit

98. Formati i saktë për një e-mail adresë është:
- (A) emrimbiemri.outlook.com
 - (B) emrimbiemri@outlook@com
 - (C) emrimbiemri-outlook.com
 - (D) emrimbiemri@outlook.com
99. Një nxënës për të shfletuar në internet po përdor njërin prej ueb shfletuesve. Cili nga programet e mëposhtme është një ueb shfletues (browser):
- (A) Word
 - (B) Google Chrome
 - (C) Excel
 - (D) PowerPoint
100. Kur është fjala për cilësinë e imazhit të punuar përmes softuerëve të vizatimit në Windows siç është Paint. Cila nga pohimet në vijim është e saktë?
- (A) Imazhi humb kualitetin kur zmadhohet
 - (B) Imazhi nuk humb kualitetin kur zmadhohet
 - (C) Imazhi ndërtohet nga vija dhe forma gjeometrike
 - (D) Imazhi ndërtohet duke u bazuar në vektorë

76. Në cilën pikë është shpejtësia më e vogël e lëvizjes gjatë rotacionit të Tokës bazuar në figurën e dhënë?


- (A) Ekuator - 0° të gjerësisë gjeografike
- (B) Rrethin tropik - $23^\circ 27'$ të gjerësisë gjeografike
- (C) Rrethin polar - $66^\circ 33'$ të gjerësisë gjeografike
- (D) Në pole - 90° të gjerësisë gjeografike




77. Si pasojë e boshtit të pjerrtë të Tokës ndaj rrafshit të ekliptikës, kohëzgjatja e ditës dhe natës nuk është e barabartë.

Në cilën pikë të figurës së dhënë kohëzgjatja e ditës është 24 orë?

- (A) Ekuator
- (B) Gjerësitë e mesme gjeografike
- (C) Polin e veriut
- (D) Polin e jugut



78. Pozita gjeografike e një lokaliteti (qyteti) caktohet me anë të koordinatave gjeografike.




Cilat janë koordinatat gjeografike të Tokios bazuar në hartën e dhënë?

- (A) $38^\circ V$ dhe $140^\circ L$
- (B) $45^\circ P$ dhe $145^\circ J$
- (C) $38^\circ J$ dhe $140^\circ P$
- (D) $40^\circ L$ dhe $145^\circ V$

79. Në hartën e dhënë është paraqitur kufiri ndërmjet Evropës dhe Azisë.

Cila ngushticë detare lidh Detin Egje dhe Detin Marmara?

- (A) Ngushtica e Doverit
- (B) Ngushtica e Dardaneleve
- (C) Ngushtica e Gjibraltarit
- (D) Ngushtica e Bosforit




80. Në hartën e dhënë është paraqitur hidrografia e Shqipërisë, me ç’rast janë identifikuar tri liqenet më të mëdha.

Cili nga rreshtat në tabelë paraqet saktë numrat e dhënë në hartë?

- (A) Rreshti a
- (B) Rreshti b
- (C) Rreshti c
- (D) Rreshti d


	LIQENI I PRESPËS	LIQENI I OHRIT	LIQENI I SHKODRËS
a	1	2	3
b	1	3	2
c	2	1	3
d	3	2	1



81. Në figurën e dhënë me numrat 1,2,3 dhe 4 është paraqitur zonaliteti vertikal i bimësisë në pjesën veriore të Shqipërisë.

Cili nga rreshtat në tabelë paraqet saktë zonalitetin vertikal të bimësisë së pjesës veriore të Shqipërisë të dhënë me numra në figurë?

- (A) Rreshti d
- (B) Rreshti c
- (C) Rreshti b
- (D) Rreshti a




	①	②	③	④
a	Shkurret mesdhetare	Dushqet	Ahu dhe haloret	Kullotat alpine
b	Ahu dhe haloret	Dushqet	Kullotat alpine	Shkurret mesdhetare
c	Kullotat alpine	Ahu dhe haloret	Dushqet	Shkurret mesdhetare
d	Dushqet	Shkurret mesdhetare	Kullotat alpine	Ahu dhe haloret

82. Në fotografi është paraqitur një lloj i shkëmbit. Karakteristikë e këtyre shkëmbinjve është se formohen nga fundërrimi (shtresëzimi) i mbetjeve të bimëve dhe kafshëve.

Për cilin lloj të shkëmbinjve bëhet fjalë?

- (A) Sedimentar kimik
- (B) Sedimentar organik
- (C) Sedimentar mekanik
- (D) Sedimentar plastik



83. Në foton e dhënë është paraqitur zona bregdetare. Forma e grykëderdhjes është krijuar nga pëmbytja e grykave të lumenjve dhe të zgjeruar nga veprimi i baticës. Ato kanë formën e hinkës dhe janë të përshtatshme për t'u shndërruar në porte.

Cila formë e grykëderdhjes është paraqitur në fotografi?

- (A) Delta
- (B) Fjordi
- (C) Estuari
- (D) Riasi



84. Në figurë është paraqitur struktura e atmosferës së Tokës në shtresa e paraqitur me numrat 1, 2, 3 dhe 4.



Cili nga rreshtat në tabelën e dhënë paraqet saktë shtresat e atmosferës të paraqitura me numra në figurë?

- (A) Rreshti d
- (B) Rreshti c
- (C) Rreshti b
- (D) Rreshti a

	1	2	3	4
a	Stratosfera	Mezosfera	Troposfera	Termosfera
b	Termosfera	Troposfera	Mezosfera	Stratosfera
c	Mezosfera	Troposfera	Termosfera	Stratosfera
d	Troposfera	Stratosfera	Mezosfera	Termosfera

85. Në hartën e dhënë më numrat 1, 2 dhe 3 paraqiten objektet natyrore ku në foto janë dhënë me shkronjat *Foto Q*, *Foto R* dhe *Foto S*.




Foto.Q Liqeni i Kuqishtes



Foto.R Shpella e Gadimes



Foto.S Ujëvara e Mirushës

Cili nga rreshtat e dhënë paraqet shkronjat Q, R dhe S në foto që i përgjigjen saktë numrave në hartë?

- (A) Rreshti a
- (B) Rreshti b
- (C) Rreshti c
- (D) Rreshti d

	①	②	③
a	Q	R	S
b	R	Q	S
c	S	R	Q
d	Q	S	R

86. Janë dhënë disa fakte për malin që gjendet në Kosovë.

- Nga ky mal buron lumi Morava e Binçës.
- Maja më e lartë është Kopilaça (1492 m).
- Gjenden në pjesën juglindore të Kosovës.
- Shtrihet edhe në Maqedoninë e Veriut dhe në Luginën e Preshevës.

Cilit mal në Kosovë i takojnë karakteristikat e mësipërme?

- (A) Rogozna
- (B) Gollaku
- (C) Karadaku
- (D) Kopaoniku

87. Në hartën e dhënë është paraqitur njëra nga regjionet gjeografike të Shqipërisë.

Cila nga krahinat (regjionet) është paraqitur në hartën e dhënë?

- (A) Malore Veriore
- (B) Malore Qendrore
- (C) Malore Jugore
- (D) Perëndimor



88. Në **fig.1** dhe **fig. 2** janë paraqitur harta që përshkruajnë monsunet gjatë stinëve në Azinë Jugore (nënkontinenti Indian).




Figura 1





Figura 2

Në cilën hartë përshkruhet saktë në alternativat e dhëna për lëvizjen e monsunëve dhe relacionet e tyre?

- (A) (Fig. 2) Monsuni veror, fryn nga oqeani në kontinent duke sjell thatësi dhe mot të ftohtë
- (B) (Fig. 2) Monsuni dimëror fryn nga kontinenti në oqean duke sjell lagështi dhe reshje
- (C) (Fig. 1) Monsuni dimëror, fryn nga kontinenti në oqean duke sjell thatësi
- (D) (Fig. 1) Monsuni veror, fryn nga oqeani në kontinent duke sjell lagështi dhe reshje

89. Në hartë është paraqitur koncentrimi i popullsisë (dendësia) në kontinentin aziatik.



Cilat regjione të Azisë kanë dendësi më të vogël të popullsisë?

- (A) Lugina e lumit Ind, Hidustani, rrafshnaltat e Dekanit dhe Kina jugore
- (B) Ultësira e Siberisë Perëndimore, stepat e Kazakistanit dhe Mongolia
- (C) Azia Jugperëndimore, Kina verilindore dhe ishujt e Japonisë
- (D) Arkipelagu i Malajeve, Azia Perëndimore dhe Azia Jugore


90. Urtina dhe Beni janë dy gjeografë të rinj të cilët po hulumtojnë veçoritë e Lumëbardhit të Deçanit me theks të veçantë prurjen e ujit dhe luginën lumore. Me cilën degë të gjeografisë po merren ata?

- (A) Gjeografi fizike
- (B) Gjeografi humane
- (C) Gjeografi ekonomike
- (D) Gjeografi regjionale

91. Në hartën e dhënë është paraqitur linja ajrore që bën aeroplani në udhëtimin disa orësh nga Nju-Jorku në Prishtinë.

Në cilat hemisfera të Tokës fluturon aeroplani?


- (A) Jugore → Veriore
- (B) Perëndimore → Lindore
- (C) Veriore → Jugore
- (D) Lindore → Perëndimore




92. Në figurën e dhënë, në profil të tërthortë janë paraqitur mali Golesh, fusha e Kosovës dhe malet e Gollakut.

Çfarë strukture tektonike-relievore paraqet fusha e Kosovës?

- (A) Antiklinal
- (B) Sinklinal
- (C) Graben
- (D) Horst



93. Në diagramin e dhënë janë paraqitur reshjet mujore dhe temperatura mujore e ajrit në stacionin e Barcelonës (Spanjë).



Cila nga pohimet e dhëna është e saktë bazuar në diagramin e dhënë?

- (A) Reshjet më të pakta janë në stinën kur temperaturat e ajrit janë më të larta
- (B) Sasia e reshjeve është më e madhe në vjeshtë për shkak të klimës kontinentale
- (C) Sasia e reshjeve është e barabartë me temperaturën mesatare vjetore
- (D) Temperatura mesatare vjetore është thujse e njëjtë gjatë gjithë muajve të vitit

94. Është dhënë teksti:

..... trevë gjeografike ndërmjet malit Rogozna dhe Malit të Thatë në jug. Lugina e lumit e lidh këtë trevë gjeografike me qytetin e Mitrovicës. Fshati Çabër është një oazë e vogël etnike brenda kësaj treve të banuar me serbë. Popullsia merret me bujqësi ekstensive, blegtori dhe pylltari. Qendra më e madhe është Zubin Potoku (2,500 banorë).

Për cilën trevë bëhet fjalë në tekstin e dhënë?

- (A) Shala e Bajgorës
- (B) Kollashini i Ibrit
- (C) Lugina e Lumbardhit
- (D) Hasi me Pashtrikun

95. Në hartë e dhënë me numrat 1,2,3,4,5,6 dhe 7 janë paraqitur malet e Kosovës.

	BJESHKËT E NEMUNA	HASI DHE PASHTRIKU	MALET E SHARRIT	MOKNA
a	1	2	3	5
b	2	4	5	7
c	4	5	1	2
d	1	2	3	4



Cili nga rreshtat në tabelë paraqet saktë numrat që paraqesin malet në hartë të cilët rrethojnë fushën e Dukagjinit?

- (A) Rreshti d
- (B) Rreshti c
- (C) Rreshti b
- (D) Rreshti a

96. Është dhënë teksti:

Nga sasia mesatare e reshjeve në Shqipëri, për shkak të kushteve relievoe e gjeologjike, rreth 60% të ujërave rrjedhin. Sasia e ujërave rrjedhëse për banor është 8,500m³/banor/vit, që e bën Shqipërinë ndër vendet më të pasura në Evropë.

Bazuar në tekstin e dhënë cila nga këto pohime tregon saktë arsyen pse Shqipëria është ndër vendet më të pasura me ujëra rrjedhëse në Evropë?

- (A) Ujërat rrjedhëse të Shqipërisë përfshijnë liqenet e shumta me origjinë natyrore dhe artificiale, prandaj rrjedh uji në sipërfaqe
- (B) Shqipëria ka klimë kontinentale, andaj masat e lagështa të ajrit vijnë nga brendia e gadishullit Ballkanik
- (C) Terreni i Shqipërisë është malor dhe ka reshje të shumta që vijnë nga masat e ajrit mesdhetare
- (D) Terreni i Shqipërisë është fushor dhe ujërat sipërfaqësore rrjedhin në drejtim të detit Adriatik dhe Jon

97. Cilat veçori gjeografike i takojnë Azisë Jugore?

- (A) Karakorumi - Ultësira Kineze - gadishulli Korean
- (B) Himalajet - Ultësira e Hindustanit - rrafshnalta e Dekanit
- (C) Hindokushi - Ultësira e Manxhurisë - ishulli Java
- (D) Mesopotamia - Ultësira Pranëkaspikë - ishujt Andaman

98. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e numrit të popullsisë dhe sipërfaqes së shteteve.

Cili prej shteteve të paraqitura në tabelë ka dendësi më të madhe të popullsisë?


- (A) ShBA-të
- (B) Kina
- (C) Indonezia
- (D) Pakistani

Shteti	Numri i banorëve (2021)	Sipërfaqja (km ²)
Kina	1,425,893,465	9,596,961
ShBA	336,997,624	9,629,091
Indonezia	273,753,191	1,910,931
Pakistani	231,402,117	881,913

99. Në piramidën e dhënë, me numrat 1, 2, 3 dhe 4 janë paraqitur grupmosha të ndryshme të popullsisë.

Cili numër tregon popullsinë aktive në aspektin ekonomik?

- (A) Numri 1
- (B) Numri 2
- (C) Numri 3
- (D) Numri 4



100. Cilat nga këto veprimtari hynë në sektorin dytësor (sekondar) të ekonomisë?

- (A) Xehetaria, industria dhe ndërtimtaria
- (B) Administrata, kultura dhe arsimi
- (C) Komunikacioni, tregtia dhe turizmi
- (D) Gjuetia, peshkataria dhe bujqësia

76. Periudha historike ndahet në katër kohë:

1. Bashkëkohore
2. Mesjetare
3. Antike
4. Moderne

Rendit kohët e periudhës historike sipas rendit kronologjik nga më e vjetra:

- (A) 2-1-3-4
 (B) 2-3-4-1
 (C) 3-2-1-4
 (D) 3-2-4-1

77. Cili ishte kontributi i Mbreti Hamurab për shoqërinë babilonase?

- (A) Ndërtimi dhe zbukurimi i tempujve
 (B) Shkrimi i ligjeve
 (C) Krijimi i bibliotekës më të madhe të asaj kohe
 (D) Lidhja e Traktatit të paqes me Asirët

78. Ku qëndron rëndësia e Kulturës së Komanit për Shqiptarët?

- (A) Argumenton vazhdimësinë iliro-arbërore
 (B) Argumenton vazhdimësinë iliro-trake
 (C) Argumenton organizimin e Themave në Arbëri
 (D) Argumenton ndarjen e Perandorisë Romake përmes trevave Arbërore

79. Harta e dhënë paraqet shtrirjen territoriale të një principate Arbërore në shek. XIV.

Cila principatë është paraqitur në pjesën e hijezuar në hartë me numrin ①?


- (A) Principata e Balshajve
 (B) Principata e Arbrit
 (C) Principata e Topiajve
 (D) Principata e Shpatajve



80. Në hartën e dhënë janë paraqitur disa nga vendet e Ballkanit të pushtuara gjatë mesjetës.

Cilat nga pushtimet janë paraqitur në hartë?

- (A) Pushtimet serbe gjatë sundimit të Car Dushanit drejt Shqipërisë
- (B) Pushtimet e para të Perandorisë Romake në Ballkan dhe Shqipëri
- (C) Pushtimet Bizantine në Ballkan dhe Shqipëri
- (D) Pushtimet e para osmane në Ballkan dhe në Shqipëri



81. Çka përfaqësonte Lidhja Shqiptare e Lezhës?

- (A) Një Principatë shqiptare për organizimin e luftës kundër Perandorisë Bizantine
- (B) Një aleancë politike e ushtarake e krijuar për luftë kundër Perandorisë Osmane
- (C) Një marrëveshje ushtarake për luftë të përbashkët me Alfonsin V kundër Perandorisë Osmane
- (D) Një organizatë politike e cila do të merrej me përgatitjet për të ngritur flamurin e Kastriotëve më 28 nëntor 1443

82. Për çfarë arsye u mbajtën Kuvendet ballkanike në Kuç (1614), Prokupleje (1616) dhe Beograd (1620)?

- (A) Për të hartuar ligjet dhe statutet që rregullonin jetën shoqërore
- (B) Për organizimin e rezistencës në Betejën e Lepantos
- (C) Për të organizuar luftë të përbashkët për çlirim nga Perandoria Osmane në bashkëpunim me aleat të jashtëm
- (D) Për të krijuar Aleancën e Shenjtë, që të luftonte kundër osmanëve, në përbërje të së cilës ishin Perandoria Austriake, Venediku dhe Polonia

83. Në hartën e dhënë janë paraqitur disa nga qytetet që ishin brenda shtrirjes territoriale të njërit nga pashallëqet shqiptare.

Cili Pashallëk është paraqitur në pjesë e hijezuar në hartë me numrin ① ?

- (A) Pashallëku i Prizrenit
- (B) Pashallëku i Shkodrës
- (C) Pashallëku i Prishtinës
- (D) Pashallëku i Shkupit



84. Në fotografi janë udhëheqësit e katër shteteve më të fuqishme evropiane të Luftës së Dytë Botërore.



Foto.1 A.Hitleri



Foto.2 V.Qerqili



Foto.3 B.Musolini



Foto.4 J.V.Stalin

Cila nga këto figura përfaqëson diktaturën fashiste në shtetin që ka drejtuar?

- (A) Foto. 1
- (B) Foto. 2
- (C) Foto. 3
- (D) Foto. 4

85. Cilat nga fiset barbare që u dynden në territorin e Ilirisë janë me origjinë gjermane ?

- (A) Ost gotet dhe Visi gotet
- (B) Kroatet dhe Polaket
- (C) Ukrainasit dhe Rumunet
- (D) Moldavët dhe Sllovakët

86. Cilat ishin pasojat e fushatave pushtuese të Aleksandërit të Madh?

- (A) Lundrimet e mëdha detare që sollën deri në zbulimin e Amerikës
- (B) Bashkimi i kulturës së Greqisë së lashtë me Kulturën e lindjes
- (C) Copëtimi i vendeve të Lindjes së lashtë dhe krijimi i dinastisë Merovinge
- (D) Ndërtimet e mëdha publike që bankrotuan arkën e shtetit maqedonas

87. Është dhënë kapitulli i një libri të Historisë

Kapitulli 1

1.1 Sistemi timar dhe krijimi i Vilajeteve

1.2 Sanxhaqet dhe Elajetet

1.3 Armata e jeniçerëve dhe luftërat e tyre

1.4 Rrënja e Konstantinopolit në vitin 1453

Cili është titulli i kapitullit 1 në librin e historisë bazuar në përmbajtjen e dhënë?

- (A) Fillimi i Luftës së Parë Botërore dhe Revolucioni i tetorit
- (B) Reformat politike dhe ushtarake brenda Perandorisë Romake
- (C) Organizimi ushtarak-administrativ dhe pushtimet e Perandorisë Osmane
- (D) Formimi i pashallëqeve shqiptare dhe rezistenca kundër Osmanve

88. Teksti i dhënë i referohet zbulimeve të mëdha gjeografike në fund të shek.XV.
“Në Botën e re u nisen njerëz nga Evropa që ishin kryesisht të varfër me shpresë se atje do të jetonin të qetë, do të pasuroheshin dhe nuk do të persekutoheshin për shkak të bindjeve fetare. Vendi i ri ju mundësoj atyre që të kenë tokë të mjaftueshme për punë si dhe nuk kishte regjim feudal për ti shtypur .Pjesa më e madhe u vendos në kolonit Angleze kështu që gjuha e komunikimit ishte anglishtja.”
 Në tekstin e dhënë bëhet fjalë për vendosjen e kolonive evropian në tokën e:
- (A) Indisë
 (B) Azisë
 (C) Australisë
 (D) Amerikës
89. Cilat personalitete i takojnë periudhës së Humanizmit dhe Renesancës evropiane?
- (A) Mikelangjelo Buonaroti, Leonardo da Vinçi, Nikolla Koperniku
 (B) Françesko Krispi, Gjyzepe Garibaldi, Antonio Vivaldi
 (C) Jul Cezari , Konstantini i Madh , Diokleciani
 (D) Gjon Kenedi, Vlladimir Iliç Lenini,Nikita Hrushqov
90. Ekspresionizmi dhe kubizmi që u paraqiten ne fillimin e shek. XX ishin:
- (A) rryma të letërsisë klasike greke
 (B) rryma të dramaturgjisë klasike romake
 (C) rryma të reja arti muzikor
 (D) rryma të reja arti figurativ
91. Në fund të shek. të XII Principata e Arbërit e udhëhequr nga Dhimitri fitoi karakteristikat e një shteti gjysëm të pavarur nga perandoria Bizantine.
 Cila nga këto vende ishte qendër e Principatës së Arbërit të udhëhequr nga Dhimitri?
- (A) Shkodra
 (B) Kruja
 (C) Epiri
 (D) Durrësi
92. Traktati i Shën Stefanit i arritur me 3 mars 1878 synonte copëtimin e tokave shqiptare nga shtetet fqinje.
 Ky traktat ishte një marrëveshje mes:
- (A) Perandorisë Osmane dhe Greqisë
 (B) Serbisë dhe Malit të Zi
 (C) Perandorisë Osmane dhe Ruisë
 (D) Bullgarisë dhe Greqisë
93. Evropa është djep i lindjes së rrymave ideologjike, shoqërore e politike progresive si: Iluminizmit, Romantizmit, Nacionalizmit dhe Kapitalizmit.
 Cila nga këto lëvizje shoqërore dhe politike bënë përpyeke që çdo komb të ketë të drejtën e bashkimit dhe formimit të shtetit kombëtar?
- (A) Iluminizmi
 (B) Nacionalizmi
 (C) Kapitalizmi
 (D) Romantizmi

94. Çfarë zhvillime solli Revolucioni i Parë Industrial?
- (A) Rritjen e industrive, si të qymyrit, hekurit, tekstileve, ndërtimit të qyteteve dhe hekurudhave
- (B) Shënoi kalimin nga monarkia absolute në monarki kushtetuese
- (C) Shënoi kalimin nga monarkia kushtetuese në republikë dhe më pas në diktaturën jakobine
- (D) Pëmbysset diktatura jakobine dhe vendoset Direktorati
95. Cilat vise shqiptare do t'i aneksonte Serbia sipas vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit?
- (A) Krahinat shqiptare të Korçës, Pogradecit, Strugës, Kaçanikut
- (B) Lumenjtë Kalama dhe Selevria, trevën shqiptare të Çamërisë
- (C) Krahinat e Tivarit, Plavës Gucisë, Rugovës dhe të Kollashinit
- (D) Viset veriore të Kosovës deri në afërsi të Mitrovicës
96. Cilat shtete e përbënin Aleancën Tripalëshe në prag të Luftës së Parë Botërore?
- (A) SHBA-të, Anglia dhe Gjermania
- (B) Anglia, Franca dhe Rusia
- (C) Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia
- (D) Japonia, Kina dhe Rusia
97. Çfarë parimi zbaton Pakti i NATO-së në rast lufte?
- (A) Sulmi ndaj cilit do anëtar të NATO-së konsiderohet sulm mbi tërë paktin
- (B) Ndërrhyrja bëhet vetëm për shtetet e mëdha që kanë interesa strategjike
- (C) Sulmi nga NATO bëhet vetëm ndaj shteteve të ish-Paktit të Varshavës
- (D) NATO aktivizohet ndaj shteteve që nuk respektojnë lirinë e fjalë dhe shtypit
98. Cili është qëllimi i Këshillit të Sigurimit të OKB-së?
- (A) Sigurimi i të drejtave dhe lirive të njeriut
- (B) Është përgjegjës për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në botë
- (C) Shërbeu gjatë Luftës së Ftohtë si organizatë për dialogë ndërmjet Lindjes dhe perëndimit
- (D) Kërkon të drejtën e popujve për vetëvendosje
99. Cili shtet fqinj i Shqipërisë kishte hartuar programin politik të quajtur "Megali Idea" që synonte aneksimin e viseve jugore shqiptare?
- (A) Mbretëria Serbe
- (B) Mbretëria Kroate
- (C) Mbretëria Bullgare
- (D) Mbretëria Greke
100. Në tabelën e dhënë janë paraqitur qeverisja, religjioni dhe sistemi pronësor në Perandorisë Habsburge? Cili nga rreshtat e dhënë në tabelë paraqet saktë qeverisjen, religjionin dhe sistemin pronësor në Perandorinë Habsburge?

	QEVERISJA	RELIGJIONI	SISTEMI PRONËSOR
(A) a	monarki	katolik	feudal
(B) b	patriarkale	ortodoks	socialist
(C) c	matriarkale	budist	kapitalist
(D) d	principatë	politeist	komunist

76. Çfarë ndikimi pati industrializimi në pozitën shoqërore të të moshuarve?

- (A) Pozita e tyre shoqërore ra
- (B) Pozita e shoqërore e burrave u ngrit, ndërsa e grave ra
- (C) Pozita e tyre shoqërore nuk u ndikua fare
- (D) Pozita e tyre shoqërore u ngrit

77. Kush e përkufizon sociologjinë si të kuptuar interpretativ të veprimit shoqëror?

- (A) Karl Marx
- (B) Emile Durkheim
- (C) Max Weber
- (D) Auguste Comte

78. Në tabelën e dhënë është paraqitur baza ekonomike e shoqërisë dhe superstruktura ideologjike e shoqërisë.

BAZA EKONOMIKE E SHOQËRISË	SUPERSTRUKTURA IDEOLOGJIKE E SHOQËRISË
Forcat e prodhimit, domethënë lënda e parë, makinat e prodhimit, fabrikat, toka, si dhe marrëdhëniet në prodhim, domethënë proletariati, borgjezia, prona private, kapitali, të mirat materiale	Arti, kultura, familja, filozofia, feja, ligji, media, sistemi politik, shkenca, arsimimi, media, rendi shoqëror

Cili autor e ka bërë këtë ndarje?

- (A) Georg Simmel
- (B) Max Weber
- (C) Emile Durkheim
- (D) Karl Marx

79. Familja, grup moshë, televizioni, çerdhet dhe shkollat që rrënjisin tek individët vlerat, qëndrimet dhe normat mbizotëruese të shoqërisë, me një fjalë quhen:

- (A) mekanizma të forcës shtetërore
- (B) institucione politike
- (C) agjentë të shoqërizimit
- (D) institucione ekonomike

80. Procesi përmes të cilit një grup gradualisht braktis normat e tij kulturore dhe përvetëson modelet e kulturës mbizotëruese, quhet:

- (A) paragjykim
- (B) asimilim
- (C) segregim
- (D) gjenocid

81. Max Weber pohon se shtresëzimi shoqëror bazohet:

- (A) në klasën ekonomike, pushtetin politik dhe statusin social ose prestigjin
- (B) në klasën ekonomike dhe pushtetin politik
- (C) vetëm në statusin social
- (D) vetëm në klasën ekonomike

82. Qasja e konfliktit shoqëror nënvizon në veçanti se sistemi arsimor:

- A ka pak rëndësi në jetën shoqërore
- B ndihmon nxënësit dhe studentët në karrierën e tyre të ardhshme
- C garanton barazinë shoqërore
- D pasqyron dhe forcon pabarazitë shoqërore

83. Sociologjia studion strukturat e një shoqërie (si për shembull, ligjet, normat, kushtet aktuale të saj) dhe se si ato ndikojnë në shoqëri; ligjshmëritë e rendit shoqëror, çfarë e mundëson qëndrueshmërinë shoqërore; lidhjet në mes strukturave shoqërore (si për shembull lidhjet midis familjes, moralit, ndarjen e punës, qeverisë, fesë). Sipas Auguste Comte-it, duke u përqendruar në këto aspekte dhe lidhje, sociologjia studion:

- A statikën shoqërore
- B funksionet shoqërore
- C dinamikën shoqërore
- D konfliktin shoqëror

84. Në shoqëritë tradicionale të komuniteteve rurale bujqësore si në foto, nuk ka ndarje shoqërore të punës dhe çdonjëri kryen punë pak a shumë të njëjta. Në shoqëri të tilla, integrimi shoqëror mundësohet nga besimet dhe vlerat e përbashkëta morale që mbretërojnë në shoqëri.

Si e ka quajtur këtë lloj integrimi, Emile Durkheim ?

- A Komunitet intim
- B Solidaritet organik
- C Solidaritet mekanik
- D Shoqëri e zgjeruar



85. Normat shoqërore janë:

- A ligji ndërkombëtar, marrëveshjet ndërshtetërore dhe ligjet shtetërore
- B praktika shoqërore që përcaktojnë kufijtë e sjelljes së pranuar të individit
- C statuti dhe rregullat e një organizate
- D kushtetuta dhe ligjet shtetërore

86. Si quhet ndryshimi në pozitën sociale gjatë jetës së një individi ?

- A Mobilitet social ndër-brezave
- B Mobilitet social horizontal
- C Mobiliteti social strukturor
- D Mobilitet social brenda brezit

87. Shtresëzimi shoqëror emërton:
- A faktin se disa njerëz punojnë më shumë se të tjerët
 - B radhitjen hierarkike të kategorive njerëzore
 - C talentin personal
 - D specializimin në punë
88. Çfarë do të thotë se raca dhe etnia janë konstrukte sociale?
- A Tiparet biologjike dhe kulturore të njerëzve bëhen vetëm atëherë kur anëtarët e një shoqërie vendosin se ato tipare janë aq të rëndësishme sa t'i kategorizojnë njerëzit sipas tyre
 - B Njerëzit nuk dallojnë për nga tiparet biologjike dhe kulturore
 - C Dallimet racore dhe etnike janë të njëjta kudo dhe kurdoherë dhe ato janë të krijuara pavarësisht shoqërive
 - D Tiparet biologjike dhe kulturore të njerëzve janë bazë e mjaftueshme për të vlerësuar se sa vlejnë njerëzit
89. Çka e cilëson një komb?
- A Kulturë, funksioni dhe struktura e një shoqërie
 - B Territori, dhe kultura e përbashkët
 - C Motivi dhe heterogjeniteti e një vendi
 - D Origjina, emocionet dhe ndjënjat e përbashkëta
90. Çka paraqet globalizimi?
- A Procesin e religjionit
 - B Zhvillimin lokal dhe vendor
 - C Procese shoqërore, ekonomike dhe politike që përfshijnë gjithë globin
 - D Zhvillimin brenda kufijve nacional dhe rajonal
91. Prirja e motivuar e një aktori shoqëror që të sillet në kundërshtim me një ose disa norma të institucionalizuara quhet:
- A qëndrim
 - B shmangie
 - C miratim
 - D bindje
92. Cilët janë faktorët që ndikuan në zhvillimin e qyteteve të para?
- A Bujqësia dhe kultura
 - B Urbanizimi
 - C Sociologjia urbane
 - D Tregtia dhe zejtaria
93. Çka nënkupton procesi i shoqërizimit?
- A Shkathtësitë, njohurit dhe qëndrimet
 - B Emocionet dhe motivacionet
 - C Përvojat shpirtërore dhe emocionale
 - D Përvojat shoqërore dhe jetike

94. Cili term e përkufizon më së miri se kush dhe çfarë jemi në raport me të tjerët në një shoqëri tradicionale?
- (A) Personaliteti
(B) Statusi
(C) Roli
(D) Etnia
95. Dukuria e globalizimit e gjeti një truall të përshtatshëm të zhvillimit të saj në Evropën pas Luftës së Dytë Botërore. Institucionet ndërkombëtare, të cilat udhëhiqin globalizmin në të kaluarën dhe sot janë:
- (A) Fondi Monetar Ndërkombëtar
(B) Korporatat multinacionale
(C) Organizatat joqeveritare
(D) Korporatat transnacionale
96. “Formë e qeverisjes, ku të gjithë qytetarët marrin pjesë në diskutimin e çështjeve të ndryshme të shoqërisë dhe marrin vendime të caktuara politike”.
Për cilin lloj të demokracisë bëhet fjalë?
- (A) Demokraci zgjedhore
(B) Demokraci liberale
(C) Demokraci e drejtpërdrejtë
(D) Demokraci përfaqësuese
97. Diktatura është një lloj i pushtetit:
- (A) ligjor
(B) absolut
(C) kushtetues
(D) përfaqësues
98. *Joni kalon shumë kohë në media sociale dhe në lojëra në internet. Kjo ndikon në aftësinë e tij për të bërë detyrat e përditshme, si puna, studimi, çështjet personale. Ai shpesh ndien një nevojë të vazhdueshme për të qenë në linjë dhe ka vështirësi në ndarjen e kohës së tij. Kjo shpesh e çon në humbje të produktivitetit dhe në ndarjen e kohës me miqtë dhe familjen, si dhe të dëmtojë marrëdhëniet personale që ka. Përveç kësaj, nëse interneti nuk funksionon, ose nëse nuk ka qasje në internet, kjo mund të sjellë ankth dhe stres, dhe mund të ndikojë në aftësinë tij për të bërë detyrat e përditshme.*
Çka tregon rasti i Jonit?
- (A) Rreziku i privatësisë
(B) Krijimi i ndarjes
(C) Shpërndarja e informacioneve të rreme
(D) Rrezikun e varësisë nga interneti
99. Toleranca përfshin pranimin dhe respektin ndaj njerëzve që kanë qëndrime, besime dhe praktika të ndryshme nga ato tona. Kjo mund të përfshijë ndërveprimin e respektueshëm me personat e tjera në komunitetin tonë, pavarësisht nga dallimet tona kulturore, fetare, racore dhe të tjera.
- Çka tregon toleranca?
- (A) Solidaritet
(B) Besime
(C) Vlerë shoqërore
(D) Normë shoqërore

100. Kultura masive, kuptohet si një set i ideve, vlerave, normave dhe pranive që përcjellin masat e gjera të njerëzve në shoqëri. Kjo kulturë është shpërndarë nëpërmjet mediave masive si televizionet, gazetatat, revistat, kinemaja, muzika, interneti, reklamat dhe rrjetet sociale. Kultura masive ka një ndikim të rëndësishëm në jetën e përditshme të njerëzve dhe në formimin e tyre si individë dhe si pjesë e një shoqërie.


Cilat janë rreziqet e kulturës masive në shoqërinë moderne?

- (A) Ndikon në rritjen e nivelit të edukimit dhe kulturën e individëve
- (B) Promovon shumëllojshmërinë kulturore dhe i nxit individët të vlerësojnë kulturën e tyre
- (C) E nxit diskutimin dhe debatin për tema kulturore të ndryshme
- (D) Ndikon në humbjen e identitetit kulturor të individit

76. Arta ka për detyrë të përshkruaj drejtimin humanist në psikologji. Çka duhet të përmbajë detyra e Artës?
- A Përshkrim se si ky drejtim ka për fokus studimin e përvojës psikologjike të individit në stadin zhvillimor të fëmijërisë
 - B Përshkrim se si ky drejtim ka për fokus studimin e sjelljes së individit në situata të ndryshme
 - C Përshkrim se si ky drejtim ka për fokus premisën se qenia njerëzore në thelb është e mirë
 - D Përshkrim se si ky drejtim ka për fokus premisën se qenia njerëzore në thelb është jo racionale
77. Agoni, një psikolog, po studion marrëdhënien shkakë-pasojë në mes të shkallës së inteligjencës të rinjtë dhe numrin dhe llojin e librave që ata lexojnë për një gjysmëvjetor akademik. Çfarë metode kërkimore po përdor Agoni?
- A Metodë përshkruese
 - B Metodë anketimi
 - C Metodë korreluese
 - D Metodë eksperimentale
78. Iliri para disa ditëve kishte një aksident të rënd në komunikacion. Si rezultat i goditjes së kokës në timonin e veturës, Iliri ka probleme të mëdha me sistemin pamor, dëgjimor dhe lëvizjen e syve. Cilën pjesë të trurit mund të ketë dëmtuar Iliri?
- A Trurin e përparmë
 - B Trurin e mesëm
 - C Trurin e prapmë
 - D Trurin anësor
79. Cila e pjesë e SNP-së vepron kur e nxisim lëvizjen tonë dhe në raste urgjente ku, zakonisht, rriten rrahjet e zemrës dhe frymëmarrja?
- A Sistemi somatik
 - B Sistemi autonom
 - C Sistemi simpatik
 - D Sistemi parasimpatik
80. Artani gjatë tërë kohës ndjehet i lodhur. Pse miku i tij, psikolog, rekomandojë Artanit të bëjë një kontroll të sistemit endokrin?
- A Të kontrollojë gjëndrën paratiroide që sekretojnë hormonin PTH sepse mund të ndikojë në lodhje
 - B Të kontrollojë gjëndrat tiroide, specifikisht tiroksinën sepse mund të ndikojë në lodhje
 - C Të kontrollojë gjëndrat mbiveshkore sepse mund të ndikojë në lodhje
 - D Të kontrollojë gjëndrat e hormonit DHEA sepse mund të ndikojë në lodhje
81. Cili hormon njihet edhe si "hormoni i stresit" sepse çlirohet gjatë momenteve të alarmit dhe tensionit?
- A Adrenalina
 - B Tiroidet
 - C Oksitocina
 - D Katekolaminat

82. Tre hapat e mëposhtëm përshkruajnë stadet e zhvillimit njerëzor:
1. Foshnjëria
 2. Prenatal
 3. Fëmijëria e hershme
- Radhitni këto periudha duke filluar nga mosha më e re:
- (A) 1 - 2 - 3
- (B) 2 - 1 - 3
- (C) 3 - 1 - 2
- (D) 3 - 2 - 1
83. Besarta është një nënë e re. Ajo gjithashtu sapo është zhvendosur në një shtet të ri. Puna e saj e re, edhe pse me përfitime materiale të mëdha, ka shumë kërkesa dhe obligime për Besartën. Ajo është e mbingarkuar. Pse psikologu i saj ka rekomanduar Besartën që të fillojë të praktikojë meditimin.
- (A) Meditimi mundëson individin që të mendojë thellësisht dhe përqendrohet në zgjedhjen e drejtë të një problemi ose situatë, duke lënë anash ngacmuesit e jashtëm dhe jo relevant
- (B) Meditimi mundëson rikujtimin e kujtimeve të shtypura dhe mundëson modifikimin e sjelljes
- (C) Meditimi mundëson humbjen e kontaktit me vetëdijen tonë
- (D) Meditimi mundëson krahasimin e gjendjes së vetëdijes tonë para dhe pas problemit ose situatës sfiduese
84. Bora ka për detyrë të shkruaj një ese rreth rëndësisë së gjumit në jetën e njeriut. Duke u bazuar në hulumtimin e saj të literaturës shkencore, Bora beson se ne flemë për të përpunuar informacionin që është fituar gjatë ditës që të bëhemi gati për ditën tjetër. Cila teori mbi gjumin shpjegon se pse flemë sipas përshkrimit të dhënë nga Bora?
- (A) Teoria e riparimit
- (B) Teoria evolucionare
- (C) Teoria e konsolidimit të informacionit
- (D) Teoria e PLSH-së
85. Vesa si fëmijë ka filluar të përdorë imazhe ose/dhe simbole mendore për të kuptuar gjërat. Sipas teorisë së zhvillimit mendor të Piagjet, në cilin stadë ndodhet Vesa?
- (A) Stadi sensimotor
- (B) Stadi paraoperacionale
- (C) Stadi operacionale konkret
- (D) Stadi operacionale formal
86. Lisin, i posalindur, sa herë që familjarët e tij prekin faqet e tij ai kthen kokën dhe hapë gojën. Pse ndodh kjo me Lisin?
- (A) Familjarët kanë mësuar Lisin të kthejë kokën kur ata prekin faqen e tij
- (B) Për shkak të refleksit Babinski
- (C) Lisi ka vëzhguar dhe mësuar nga vëllau dhe motra e tij të kthejë kokën sa herë që preken faqet e tij
- (D) Për shkak të refleksit të kërkimit
87. Cili është procesi i të nxënies në të cilin një stimulus i dobët lidhet me një stimulus të fortë, duke prodhuar një reagim të ngjashëm?
- (A) Kushtëzim operant
- (B) Kushtëzim instrumental
- (C) Kushtëzim klasik
- (D) Kushtëzim automatik

88. Cila nga pohimet është e saktë për Burimin i cili vuan nga amnezia retrograde?
- (A) Burimi ka humbje të aftësive për të mbajtur mend edhe për të riprodhuar kujtime për ngjarjet e materialet e mësuara para se të shfaqet amnezia
 - (B) Burimi ka humbje të aftësive për të mbajtur mend edhe për të riprodhuar të gjithë atë që mëson dhe përjeton pas shfaqjes së amnezisë
 - (C) Burimi ka humbje të aftësive për të mbajtur mend që nga fëmijëria
 - (D) Burimi ka humbje të aftësive për të riprodhuar kujtime që nga fëmijëria
89. Drini ka temperament që ka nxitje dhe frenim të mirë, është i ngrohtë, i qeshur dhe optimist, i këndshëm në shoqëri, komod në punë.
Çfarë lloj temperamenti ka Drini?
- (A) Tipi melankolik
 - (B) Tipi kolerik
 - (C) Tipi flegmatik
 - (D) Tipi sanguin
90. "Të gjithë burrat janë kuzhinierë të mirë!" Ky pohim është:
- (A) diskriminim
 - (B) diskutim
 - (C) stereotip
 - (D) paragjykim
91. Në figurë me numrin 1, 2, 3 dhe 4 janë paraqitur disa pjesë të qelizës nervore:



Cilët nga rreshtat në tabelë i përgjigjen saktë funksioneve të një qelize bazuar në figurën e dhënë?


	BART INFORMACIONE NGA TRUPI I QELIZËS DREJT DENTRITEVE TË NEURONIT TJETËR	LIDH DENTRITET ME AKSONIN	TRANSMETON SINJALE ELEKTRIKE NGA NJË VEND NË TJETRIN NË SN.	MARRIN INFORMACION NGA NEURONET E TJERA DHE E PËRCJELLIN ATË TEK TRUPI QELIZËS
a	2	1	3	4
b	2	3	4	1
c	3	2	1	4
d	3	2	4	1

- (A) a
- (B) b
- (C) c
- (D) d

92. Në figurën e dhënë me numrin 1,2,3 dhe 4 janë paraqitur disa pjesë të trurit të njeriut.

Cili numër në figurën e dhënë tregon pjesën e trurit të përparmë, që përbëhet nga një grup i madh aksonesh, që lidh dy hemisferat e trurit ?

- (A) 1
- (B) 2
- (C) 3
- (D) 4



93. Kur profesori i Psikologjisë po shpjegonte për zgjedhjen e profesioneve, e pyeti Kronin se çka i pëlqente të studioje, Kroni u shpreh që dua të studioj në Departamentin e Psikologjisë dhe të vazhdoje studimet për proceset mendore si: perceptimi, të menduarit, kujtesën dhe zgjidhjen e problemeve. Nga kjo bisedë u kuptua se Kroni ishte i orientuar të studioje Psikologjinë dhe të vazhdoje për:

- (A) psikologjinë shkollore
- (B) psikologjinë organizative
- (C) psikologjinë e njohjes
- (D) psikologjinë e edukimit

94. Arti ishte në një vizitë tek Oftalmologu - mjeku i syve. Pas vizitës, mjeku konstatoi se sytë e Artit kishin humbur aftësinë për të lexuar dhe për t'i parë qartë objektet që i kisha afër.

Cila është diagnoza e të pamurit tek Arti sipas Oftalmologut?

- (A) Presbiopi
- (B) Astigmatizëm
- (C) Miopi
- (D) Hipermetropi

95. Bjeshka si foshnje ishte shumë e qeshur ku edhe më të ëmbël e bënin tingujt që nxirrte nga goja, ku Bjeshka thoshte: "jashtë" - për të nënkuptuar "dua të dal jashtë", apo fjalën "ujë" për të nënkuptuar "më pihet ujë". Si njihet ky lloj i të folurit tek Bjeshka?


- (A) Të folurit me Belbëzim
- (B) Të folurit Holofrazik
- (C) Të folurit Telegrafik
- (D) Të folurit me Gugatin

96. Kapitulli në një tekst shkollor të psikologjisë
Kapitulli 3
3.1 Kujtesa si proces psikik
3.2 Faktorët që ndikojnë në kujtesë
3.3 Llojet dhe çrregullimet e kujtesës
3.3. Zgjidhja e problemeve
Sipër shihni një pjesë të tabelës së përmbajtjes të një teksti të psikologjisë
Çfarë titulli do të ketë kapitulli 3
- (A) Biopsikologjia
 (B) Zhvillimi dhe të nxëniet
 (C) Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë
 (D) Kognitiviteti
97. Cili nga drejtimi në vijim, konsiderohet si drejtim i ri në psikologji?
- (A) Drejtimi humanist
 (B) Drejtimi psikoanalist
 (C) Drejtimi geshtalist
 (D) Drejtimi bihejviorist
98. Amiri para testit të maturës po mbante ligjërata shtesë për ata nxënës që e kanë zgjedh lëndën e Psikologjisë. Në këtë ligjëratë, ai po shpjegonte se si disa nxënës janë më të shkathët ,më komunikues, më të hapur dhe më të gjallë si tipa ndërsa, disa të tjerë i shpjegoi si më të ngadaltë, fjalëpakë, të mbyllur e të ndrojtur. Cilën teori po e shpjegonte Amiri?
- (A) Teorin e Frojdit
 (B) Teorin e Jungut
 (C) Teorin e Allportit
 (D) Teorin e Adlerit
99. Gjatë matjes së inteligjencës, Albina kishte moshën mendore 12 vjeç ndërsa moshën kronologjike 15 vjeç. Sa është inteligjenca e Albinës:
- (A) 135
 (B) 125
 (C) 105
 (D) 80
100. Dy ditë para testit të maturës Kroni dhe Mentori diskutonin për dy llojet e mendimeve. Kroni thoshte se kemi raste kur nisemi me e zgjidh një problem dhe përfundojmë me një zgjidhje të vetme të saktë, ndërsa, Mentori thoshte që një problem mund të ketë shumë zgjidhje të ndryshme. Për cilën qasje diskutonin Kroni dhe Mentori?
- (A) Qasja e përshkruese
 (B) Qasja psikodinamike
 (C) Qasja e studimit të rastit
 (D) Qasja kognitive

76. Cilat kategori janë koncepte makroekonomike?

- (A) Renta, paga, dhe kamata (interesi)
- (B) Kërkesa individuale dhe oferta individuale
- (C) Inflacioni, punësimi dhe papunësia
- (D) Çmimet e tregut dhe ndryshimet e tyre


77. Në grafik është paraqitur lakorja e kërkesës.



Çka ndodhë nëse lëvizet nga pika A në pikën B?

- (A) Ulje të çmimit
- (B) Rritje të çmimit
- (C) Ulje e prodhimit
- (D) Rritje e të ardhurave

78. Në grafik është paraqitur ekuilibri i tregut ndërmjet ofertës dhe kërkesës



Për cilën sasi të produkteve do të ketë tepriçë në treg?

- (A) 6 njësi
- (B) 4 njësi
- (C) 8 njësi
- (D) 12 njësi

79. Në tabelen e dhënë është bërë përshkrimi i simboleve për llogaritjen e Bruto Produktit Vendor (GDP)

SIMBOLI	PËRSHKRIMI
Y	Bruto Produkti Vendor
P	Prodhimi
T	Tregtia
Ç	Çmimet
C	Konsumi
G	Shpenzimet qeveritare
I	Investimet
NX	Eksporti neto
F	Fitimi
H	Humbja

Sipas cilës formulë llogaritet Bruto Produkti Vendor (GDP)?

- (A) $GDP = P + T + Ç + X$
- (B) $Y = C + G + I + NX$
- (C) $F = T + X + P + I$
- (D) $P = Ç + F - H + G$
80. Çka kuptoni me konkurrencën në treg?
- (A) Garë ndërmjet firmave me shumë oferta
- (B) Ndalimi i firmave tjera të hyjnë në treg
- (C) Uzurpimi ose kontrolli i tregut
- (D) Garë ndërmjet konsumatorëve
81. Çka do të thotë monopol në treg?
- (A) Shumë firma kanë aleancë për mbizotërimin e tregut
- (B) Organi rregullativ i qeverisë cakton çmimet
- (C) Disa firma e kontrollojnë tregun në tëresi
- (D) Një firmë dominon në treg dhe dikton çmimet
82. Si përcaktohet sasia e prodhimit në ekonominë e tregut?
- (A) Me vendimet e qeverisë
- (B) Me planet e prodhuesve
- (C) Me aftësinë blerëse të konsumatorëve
- (D) Me kërkesat e konsumatorëve
83. Cili ishte shkak i rritjes së çmimeve pas pandemisë COVID-19 dhe heqjes së kufizimeve?
- (A) Kërkesës së akumuluar për shkak të mbylljes nëpër shtëpia
- (B) Çrregullimit në zinxhirin e furnizimit dhe rënies së ofertës
- (C) Nivelit të lartë të infeksioneve të popullsisë
- (D) Mungesën e pamjaftueshme e subvencioneve nga qeveria
84. Në tabelen e dhënë është paraqitur kërkesa dhe oferta për biçikleta:


Çmimi	Sasia e ofruar	Sasia e kërkuar
300	6000	1000
250	5000	2500
200	4000	4000
150	3000	5500

Sa do të jetë çmimi ekuilibruar mes sasisë së ofruar dhe sasisë së kërkuar për biçikleta?

- (A) 300 euro
- (B) 250 euro
- (C) 200 euro
- (D) 150 euro

85. Në kushtet e konkurrencës së plotë çfarë ndodh me çmimet në rastet kur oferta është më e vogël se kërkesa:
- A çmimet rriten
 - B çmimet zvogëlohen
 - C çmimet mbesin të njëjta
 - D çmimet në fillim zvogëlohen e pastaj stagnojnë
86. Çka paraqet deficitin-mungesa buxhetore?
- A Tejkalinin e të hyrave publike në krahasim me shpenzimet publike
 - B Kur të hyrat publike dhe shpenzimet publike janë të barabarta
 - C Tejkalimi i shpenzimeve publike në krahasim me të hyrat publike
 - D Kur të hyrat dhe shpenzimet nuk janë të barabarta
87. Çka është amortizimi i kapitalit?
- A Shtim i vlerës së mjeteve themelore
 - B Kategori e shpenzimeve dhe humbje e vlerës
 - C Kapital i riinvestuar që sjell të ardhura
 - D Investim në riparim dhe sanimin e dëmëve
88. Cili është rezultati i kursimeve të shumë parave si depozita të afatizuara në banka?
- A Nxitë rritjen dhe zhvillimin ekonomik në afat të shkurt
 - B Mundësia që të ndikon në ecuritë ekonomike është zero
 - C Ndikon në rënien e ofertës për kredi
 - D Shkakton rënien e investimeve dhe konsumit
89. Cila politikë makroekonomike i mungon Kosovës për stabilizim makroekonomik?
- A Politika fiskale
 - B Politika monetare
 - C Politika e të ardhurave
 - D Politika e mikqyrjes financiare
90. Çka është kosto oportune?
- A Anashkalimi i një alternative në favor të alternativës më të mirë
 - B Zgjedhja e mundësisë që e kemi në dispozicion për një zgjedhje tjetër
 - C Përfitimi duke e demtuar dikë për llogarinë tonë
 - D Shpenzimi i papritur që na shfaqet gjatë aktivitetit
91. Çka është Ligji i kërkesës?
- A Është i rregulluar me urdhëresë administrative
 - B Sasia dhe çmimi janë në ekuilibër
 - C Rritja e çmimit e rritë më shumë kërkesën
 - D Sasia e kërkuar në relacion të kundërt me çmimin

92. Në figurë është paraqitur Lakorja - kurba e Philipsit e cila matë raportin ndërmjet papunësisë dhe inflacionit:



Çka shkakton rritja e inflacionit me këtë rast?


- (A) Ndikon në uljen e çmimeve
- (B) Uljen e papunësisë
- (C) Rritjen e papunësisë
- (D) Efekti në papunësi është zero

93. Çka mat elasticiteti i kërkesës në raport me çmimin?

- (A) Ndryshimin e kërkesës kur ndryshon çmimi
- (B) Mosndryshimin e kërkesës dhe çmimit
- (C) Rritjen e kërkesës dhe rënien e çmimit
- (D) Rënien e kërkesës dhe rritjen e çmimit

94. Çka ndodhë me elasticitetin siç është paraqitur në grafik, ku E- Ekuilibri?

- (A) Rritet çmimi kur ka mungesë të mallit
- (B) Mbetet i njëjtë edhe çmimi edhe sasia e mallit të kërkuar
- (C) Rritet kur rritet sasia e mallit të kërkuar
- (D) Zvogëlohet kur rritet sasia e mallit të kërkuar



95. Si ndikojnë më së shumti kuotat e importit brenda një vendi?

- (A) Mbrojtjen e prodhuesve vendor
- (B) Rritjen e shpenzimeve administrative doganore
- (C) Rritjen e çmimeve të mallrave të njëjta brenda vendit
- (D) Ndikimi i tij në ekonominë e një vendi është zero

96. Kush i cakton normat e kamatës për kredi bankare në Kosovë?

- (A) Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
- (B) Ministria e Financave
- (C) Qeveria e Republikës së Kosovës
- (D) Konkurrenca në tregun për kredi

97. Cka është monopoli?
- A Zhvendosja i një produkti ose shërbimi në disa firma
 - B Përqëndrimi i një produkti ose shërbimi vetëm të një firmë
 - C Përqëndrimi i një produkti ose shërbimi në dy firma
 - D Zhvendosja një produkti ose shërbimi tek një firmë tjetër
98. Çka paraqet kursi i këmbimit të valutave?
- A Këmbimin e parave për mallra dhe shërbime
 - B Këmbimin e një valute në raport me dollarin amerikan dhe euron
 - C Çmimin e një valute kundrejt valutës tjetër
 - D Çmimin e një valute për blerjen e letrave me vlerë
99. Çka paraqet bilanci tregtar i një vendi në tregtinë ndërkombëtare?
- A Suficitin - tepicën, deficitin - mungesën ose ekuilibrin tregtar
 - B Mallrat të cilët janë kontraktuar por nuk janë eksportuar
 - C Marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale tregtare
 - D Sanksionet ekonomike ndaj vendeve të caktuara
100. Çka është bilanci i suksesit në kontabilitetin e firmës?
- A Regjistrim për sasinë e mallrave dhe shërbimeve
 - B Pasqyrë e aktivës dhe e pasivës
 - C Pasqyrë e fitimit apo e humbjes
 - D Regjistër i pagesës me rregull për shpenzimet fikse dhe variable

76. Në rrethanat kur deklarimi i qytetarëve të një vendi për një çështje apo kauzë politike-shoqërore bëhet përmes referendumit si mjet demokratik, atëherë kemi të bëjë me demokraci të:
- (A) mazhoritare
 - (B) drejtpërdrejtë
 - (C) tërthortë
 - (D) proporcionale
77. E drejta e qytetarëve për të qenë të informuar për herë të parë u garantua edhe me ligj në vitin 1766 në:
- (A) Angli
 - (B) Francë
 - (C) Holandë
 - (D) Suedi
78. Martin Luter King, Jr., njihet si njëri nga aktivistët më të mëdhenjtë në historinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të viteve '60-ta në fushatën kundër:
- (A) diskriminimit gjinor
 - (B) diskriminimit racor
 - (C) diskriminimit etnik
 - (D) luftës në Vietnam
79. Në rastet kur në raportet shoqërore një person apo grup personash e diskriminojnë një person apo grup tjetër personash për shkak të përkatësisë së tyre etnike, pamjes fizike, prejardhjes, atëherë ky veprim mund të cilësohet si:
- (A) historicizëm
 - (B) rajonalizëm
 - (C) racizëm
 - (D) personalizëm
80. Që nga viti 1992, Organizata e Kombeve të Bashkuara, ka organizuar disa konferenca ndërkombëtare me pjesëmarrës nga të gjitha vendet e botës për të diskutuar për të ardhmen e zhvillimit të planetit tonë. Ata vendosen disa objektiva për një zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes, por pa minimizuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre. Si njihet ky lloj i modelit zhvillimor?
- (A) Zhvillim i qëndrueshëm
 - (B) Zhvillim i garantuar
 - (C) Zhvillim i paqëndrueshëm
 - (D) Zhvillim i kushtueshëm
81. Me cilin çmim u nderua ish-presidenti finlandez Marti Ahtisari, i cili kontribuoi në promovimin e paqes në botë dhe rolin e tij në përpjekje për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës?
- (A) Çmimin Oscar
 - (B) Çmimin Global
 - (C) Çmimin Nobel
 - (D) Çmimin Saharov

82. Në rrethanat kur një lider politik arrin të marr një post udhëheqës në jetën institucionale të një vendi në sajë të një mbështetje që ka marrë përmes votave të qytetarëve nga një proces elektoral, atëherë themi se ky lider është:
- (A) legjitim
 - (B) legal
 - (C) ilegjitim
 - (D) ilegal
83. Si quhet një proces i shpërndarjes ose rishpërndarjes së funksioneve, fuqive, njerëzve apo gjërave larg nga një vendndodhje ose autoritet qendror?
- (A) Alokim
 - (B) Konvokim
 - (C) Centralizim
 - (D) Decentralizim
84. Si quhen trupat punuese në kuadër të Parlamentit, të cilat ushtojnë funksione të caktuara për çështje specifike?
- (A) Seance parlamentare
 - (B) Sekretariat i parlamentit
 - (C) Komisione parlamentare
 - (D) Kryesi e parlamentit
85. Çfarë lloj të imunitetit kanë deputetët e Kuvendit të Kosovës sipas kushtetutës së vendit tonë?
- (A) Imunitet nga INTERPOL
 - (B) Imunitet nga ndjekjet penale jashtë Kuvendit të Kosovës
 - (C) Deputetët nuk kanë fare imunitet
 - (D) Imunitetet funksional brenda Kuvendit të Kosovës
86. Në rrethanat kur ju do të bëheshit pjesë e një grupi, brenda të cilit do të krijonit raporte shoqërore të ndryshme për kryerjen e veprimtarive dhe proceseve të caktuara shoqërore, e të cilat do të ishin në shërbim të plotësimit të nevojave të përbashkëta jetësore, atëherë ky do të ishte një:
- (A) grup asocial
 - (B) grup social
 - (C) grup joformal
 - (D) grup formal
87. Cila është shkalla më e lartë të dënimit për persona që me dashje kanë bërë veprë të rëndë penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës?
- (A) Burgim i përjetshëm
 - (B) Dënim me vdekje
 - (C) Burgim deri në 20 vjet
 - (D) Gjobë deri në 1,000,000 (një milion) euro

88. Gresa është qytetare e Kosovës, e cila është juriste me një reputacion të lartë profesional dhe integritet personal. Në procedurë për tu bërë gjyqtare, atë e ka propozuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe se tani, sipas kushtetutës së Kosovë, ajo bëhet gjykatëse vetëm pasi të emërohet nga:
- (A) Kryetari i Gjykatës Supreme
 (B) Presidenti i Kosovës
 (C) Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
 (D) Kryeministri i Kosovës
89. Beni, një mësues i lëndës së edukatës qytetare, po shpjegonte rrymën filozofike, e cila ka nxitur ndryshime të mëdha në Evropën e shekullit XVIII-XIX në fushat si shkencë, arti, letërsia dhe teologjia, ka promovuar idenë e ndarjes së kishës nga shteti, qeverisjen kushtetuese, lirinë individuale dhe tolerancë. Cila është tema që po shpjegonte Beni?
- (A) Iluminizmin
 (B) Konservatorizmin
 (C) Liberalizmin
 (D) Inkuizicionin
90. Dokumentet që kanë ndikuar fuqishëm në promovimin dhe garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut gjatë periudhave të caktuara të historisë janë dhënë si në vijim:
1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
 2. Manga Carta Libertatem
 3. Akti Final i Helsinkut
- Cila renditje është e saktë sipas kronologjisë nga dokumenti më i vjetër deri tek më i ri?
- (A) 1 - 2 - 3
 (B) 1 - 3 - 2
 (C) 2 - 3 - 1
 (D) 2 - 1 - 3
91. Në foton e dhënë tregohet se si ndërmjet viteve 1941-1945, në mënyrë sistematike, Gjermania naziste kreu krimet më të rënda të gjenocidit kundër Hebrenjve të Evropës. Si njihen këto krime famëkeqe në historiografinë botërore?
- (A) Holokaust
 (B) Holografi
 (C) Hipokaust
 (D) Hipokampust



93. Një qytetar i Kosovës i cili hynë në garë elektorale për të fituar mandatin e këshilltarit komunal në një tërësi prej komunave në Republikën e Kosovës, atëherë këtë synim e realizon vetëm:
- (A) kur e emëron ministri i pushteti lokal të qeverisë së Kosovës
 (B) kur e emëron një grup i caktuar zgjedhësve në një komunë
 (C) kur merr numrin e nevojshëm të votave për t'u zgjedhur nga qytetarët e një komune
 (D) kur atë automatikisht e emëron kryetari i komunës
94. Kosova po bënë përpjekje për anëtarësim në mekanizma të ndryshëm të bashkëpunimit rajonal. Ajo tani ka aplikuar për anëtarësim në një tërësi prej organizatave më të rëndësishme evropiane, e cila aktualisht ka 46 anëtar dhe merret me promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë, lirisë së mediave, etj. Për cilin institucion bëhet fjalë?
- (A) Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
 (B) Këshillin e Evropës
 (C) Bashkimin Evropian
 (D) Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO)
95. Në formë grafike është dhënë shenja '3-R', e cila simbolizon procesin përmes të cilit synohet të krijohen sa më pak mbeturina, me qëllim të ruajtjes së ambientit ku jetojmë.

Nga cilat komponentë përbëhet ky proces?

- (A) Reformimi, Riprodhimi, Ritrajtimi
 (B) Rezervim, Reanimim, Raportimi
 (C) Riformulimi, Ridizajnimi, Rekrutimi
 (D) Riciklimi, Ripërdorimi, Reduktimi



96. Praktika ka dëshmuar se në disa shoqëri post-konfliktuale, në saje të aplikimit të drejtësisë tranzicionale, mekanizmat e drejtësisë ndërkombëtare dhe shtetet e caktuara kanë arritur që ti dëmshpërblejnë viktimat e caktuara të cilëve iu janë shkelur të drejtat e njeriut. Atëherë, si njihet kjo praktikë?
- (A) Reparacion
 (B) Padi
 (C) Amnisti
 (D) Reputacion

97. Në fotografinë e dhënë është paraqitur një qytetar i Kosovës i cili po vendoste fletëvotimin e tij në kutinë e votimit.



Në fletëvotimin e tij ai kishte zgjedhur vetëm një subjekt politik dhe deri në pesë kandidat për ti votuar sipas dëshirës së tij. Kjo gjë iu mundësua atij për faktin se në Kosovë aplikohet sistemi elektorale:

- (A) mazhoritar, me shumë zona zgjedhore dhe lista të hapura
 (B) proporcional, me një zonë zgjedhore dhe me lista të hapura
 (C) proporcional, me shumë zona zgjedhore dhe me lista të mbyllura
 (D) mazhoritar, me një zonë zgjedhore dhe lista të mbyllura

98. Përfaqësimi i një shteti në arenën ndërkombëtare bëhet nga përfaqësuesit përkatës të organeve shtetërore të tij. Cili prej opsioneve të dhëna tregon linjën e saktë hierarkike në bazë të fuqisë të këtyre përfaqësuesve?
- (A) Ministri i Punëve të Jashtme, Diplomatët, Presidenti, Kryeministri
 - (B) Kryeministri, Presidenti, Diplomatët, Ministri i Punëve të Jashtme
 - (C) Presidenti, Kryeministri, Ministri i Punëve të Jashtme, Diplomatët
 - (D) Diplomatët, Ministri i Punëve të Jashtme, Kryeministri, Presidenti

99. Në fotografinë e dhënë është paraqitur presidentja e Republikës së Kosovës, e cila, si përfaqësuese e unitetit të popullit të Kosovës, po mbante fjalimin e saj vjetor para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke iu drejtuar qytetarëve të vendit tonë.

Pasi që Kosova është republikë parlamentare, ky adresim i presidentes vije për shkak se ajo është pjesë e:

- (A) deputete e kuvendit
- (B) pushtetit ekzekutiv
- (C) e qeverisë
- (D) e pushtetit legjislativ



100. Në raste të caktuara, ka ndodhur që disa prej presidentëve të Republikës së Kosovës, të kenë falur disa persona të burgosur. Këtë veprim ata e kanë bërë në sajë të kompetencave kushtetuese që ata kanë. Si quhet akti juridik përmes të cilit presidentët e kanë bërë një gjë të tillë?
- (A) Rezolutë
 - (B) Ligj
 - (C) Dekret
 - (D) Rregullore

76. Si queshin varrezat e para mbretërore egjiptiane, të cilat i paraprinë Piramidave?

- A Katakombe
- B Zigurat
- C Mastaba
- D Sarkofag

77. Cilit stil arkitektonik grek i takon shtylla e paraqitur në foto (Fig.1)?

- A Stilit Korintik
- B Stilit Jonik
- C Stilit Arkaik
- D Stilit Dorik



Fig.1

78. Kryevepra skulpturale e Fidias nga periudha e Artit Klasik grek është:

- A Athena Partenosi
- B Apollo
- C Hedhësi i Diskut
- D Zeusi

79. Ku paraqitej Arti i Mesjetar?

- A Në piktura dhe dekorime me motive të kafshëve
- B Në katedrale, kisha, bizhuteritë personale, mozaiqe, në manuskripte
- C Në artin abstrakt pa figura të njerëzve dhe kafshëve
- D Në shtëpitë e klerikëve të pasur, në muralet e pikturuara, dhe tapiseritë murale

80. Artisti i cili i refuzonte imponimet në pikturën e tij. Pikturoi natyrën, barinjë dhe fshatarët shqiptarë, qytete dhe kalorës, praktikoj perspektivën negative. Veprat e kujt karakterizoheshin me këto tipare (Fig.2)?

- A Onufrit
- B Athanas Zografit
- C Simonit të Ardenicës
- D Jeromonakut



Fig. 2

81. Dobësia ndaj frymës së barokut i paraqitur përmes fronit të gdhendur në stilin barok, veshjet me materiale luksoze dhe me dantella i shquajnë ikonat e:
- (A) Vëllëzërve Çetiri
 - (B) Shpatarakut
 - (C) Vëllëzërve Korçari (Zografi)
 - (D) Ndinit

Pyetjet nr. 82 dhe 83 i referohen skulpturës së paraqitur në figurën nr.3

82. Cili është autori që e realizoi kryeveprën e skulpturës së Renesancës së hershme me titull “Davidi” të paraqitur në fig. nr. 3 ?

- (A) Brankusi
- (B) Gjiberti
- (C) Mazaçio
- (D) Donatello




Fig.3

83. Skulptura e paraqitur në foto konsiderohet si:

- (A) Skulptura e parë kolosale prej memeri pas antikitetit
- (B) Skulptura e parë statike nga Baroku
- (C) Skulptura e parë e zhveshur pas antikitetit
- (D) Skulptura e parë arkaike nga Mesjeta

84. Përshkruaj veçoritë e ripërtritjes së përgjithshme në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore që e veçon artin e renesancës.

- (A) Arti i realizmit natyral, ringjallje e antikitetit klasik, art i kreativitetit dhe invencionit
- (B) Arti i mbështetur në përvojën tradicionale konservative religjioze
- (C) Arti i paraqitjes jofigurative
- (D) Arti pa perspektivë lineare dhe pikë zhdukëse

85. Rilindja Veriore, për dallim nga Rilindja italiane nuk tregonte absolutisht asnjë interes për Antikitetin Klasik Greko-Romak. Si e paraqiten natyrën Rilindasit Verior?

- (A) E pasqyruan natyrën ekspresive
- (B) E pasqyruan natyrën sipas imagjinatës
- (C) E pasqyruan natyrën me idealizëm
- (D) E pasqyruan natyrën me besnikëri

86. Veprat që dallohen në këtë periudhë janë stilistikisht komplekse, madje kontradiktore. Cilit stil i takon dëshira për të evokuar gjendje emocionale duke iu drejtuar shqisave në mënyra dramatike dhe është baza e paraqitjes së këtyre pikturave?

- (A) Manierizmit
- (B) Rokokos
- (C) Barokut
- (D) Romantizmit

Pyetjet nr. 87 dhe 88 i referohen pikturës së paraqitur në figurën nr. 4

87. Cili artist e realizoi pikturën e paraqitur në foto?

- (A) Rembrandt Van Rinj
- (B) Piter Paul Rubens
- (C) Leonardo da Vinçi
- (D) Vincent Van Gogh

88. Nëse e analizojmë pikturën e paraqitur në foto gjeni se cilat janë karakteristikat kryesore me të cilat dallohet kjo vepër?

- (A) Hamoni të trajtave
- (B) Skenë e qetë
- (C) Forma të ngurta
- (D) Dinamizëm dhe teatralitet



Fig.4

89. Cili ishte artisti i njohur francez i pikturës së prezentuar në foto i njohur për krijimin e zhanrit në pikturë me tema nga ahengjet në parqe, të njerëzve me kostume të vallëzimit ose maskenbaleve në shek. XVIII (Fig.5)?

- (A) Antuen Uato
- (B) Bushe
- (C) Tiepollo
- (D) Klod Zhillo



Fig. 5

Pyetjet nr. 90 dhe 91 i referohen skulpturës së paraqitur në figurën nr. 6

90. Cili skulptor e realizoi skulpturën e paraqitur në foto?

- (A) Mazaço
- (B) Roden
- (C) El Greko
- (D) Kanova



Fig. 6

91. Analizoni skulpturën e paraqitur në foto dhe gjeni se nga u frymëzua artisti për realizimin e kësaj vepre?

- (A) Nga ashpërsia dhe vrazhdësia e skulpturave egjiptiane
- (B) Nga bukuria dhe elegance e skulpturave klasike
- (C) Nga ashpërsia dhe vrazhdësia e skulpturave mesjetare
- (D) Nga bukuria dhe elegance e skulpturave të ngurta

92. Arkitekturën e shek. XIX e karakterizojnë dy principe. Cilat janë ato?

- (A) Arkitektura minimaliste, përdorimi i trajtave gjeometrike nga kromi dhe alumini
- (B) Pa ndonjë stil të përcaktuar me përdorimin e tullave dhe drurit
- (C) Vazhdimi i stilit tradicional dhe filimi i stilit të ri me materiale dhe nevojave të reja industriale
- (D) Arkitektura kontemporane me preference futuriste

Pyetjet nr. 93 dhe 94 i referohen pikturës së paraqitur në figurën nr.7

93. Nëse e analizojmë stilin e pikturimit, gjeni se cilës periudhë të artit i takon piktura e paraqitur në foto?

- (A) Rokokos
- (B) Romantizmit
- (C) Renesancës
- (D) Manierizmit



Fig.7

94. Edhe pse artisti Zheriko në artin e tij ka paraqitur skena të tmerrshme dhune, për pikturën “Trapi i Meduzës” si kompozicion ka zgjedhur momentin e paraqitjes së shpresës në horizont. Cila ngjarje pasqyrohet në pikturën e artistit?

- (A) Drama e të mbijetuarve në det pas fundosjes së anijes së mallrave franceze
- (B) Migrimi për në tokën e premtuar
- (C) Drama e të mbijetuarve të një anijeje të mbytur të Marinës Mbretërore Franceze
- (D) Lundrimi në detin e trazuar

95. Edhe pse gjatë jetës së tij punoi mbi 800 piktura dhe 700 vizatime, ai shiti vetëm një punim. Puna e tij ndikoi në zhvillimin e pikturës moderne, si fovizmin dhe ekspresionizmin gjerman. Për cilin artist holandez bëhet fjalë?

- (A) Van Gogun
- (B) Lutrekun
- (C) Gogenin
- (D) Anton Mauve

96. Lëvizjet e fuqishme të brushave, format e ngurta dhe paraqitja e realitetit ashtu siç e ndjenë në mendje artisti e karakterizojnë pikturat e artistit Xhems Ensor. Cilin stil e paraqet piktura në fig.8?

- (A) Futurizmin
- (B) Realizmin amerikan
- (C) Ekspresionizmin
- (D) Artin gjeometrik abstrakt



Fig.8

97. Cili ishte elementi kryesor figurativ dhe qendra e vëmendjes për artistët e futurizmit?

- (A) Vëllimi
- (B) Lëvizja
- (C) Ndjenja
- (D) Drita

98. Një herë në pyetjen drejtuar Pikasos për përmbajtjen e pikturës, ai përgjigjet “nuk është në piktorin të shpjegoj përmbajtjen. Përndryshe ai do ta shkruante me fjalë. Publiku duhet t’i interpretojë ashtu siç i kuptonë ato”. Si quhet punimi i tij me motive nga tmerret e luftës i dhënë në foto (Fig.9)?

- (A) Masakra në Kore
- (B) Gemika
- (C) Girona
- (D) Shtëpia në Qarnëll



Fig.9

Pyetja nr. 99 dhe 100 i referohet pikturës së paraqitur në figurën nr. 10

99. Vepra në foto është njëra nga veprat më të njohura të piktorit të njohur shqiptar. Cili është autori i saj?

- (A) Muslim Mulliqi
- (B) Tahir Emra
- (C) Ibrahim Kodra
- (D) Ibrahim Ponosheci



Fig.10

100. Nëse e analizojmë mënyrën e realizimit të pikturës së paraqitur në foto, cilit stil i takon kjo pikturë?

- (A) Dadaizmit
- (B) Futurizmit
- (C) Ekspresionizmit
- (D) Suprematizmit

76. Cilës oktavë i takon kjo notë?

- (A) Oktavës së parë
- (B) Oktavës së vogël
- (C) Oktavës së madhe
- (D) Oktavës kontra



77. Në cilin opsion është dhënë saktë distanca e gjysëmtonit diatonik?

- (A)
- (B)
- (C)
- (D)

78. Në cilin opsion është dhënë saktë vlera ritmike 4/4?

- (A)
- (B)
- (C)
- (D)

79. Cila shkallë mol i ka 5 bemola?

- (A) c-mol
- (B) b-mol
- (C) f-mol
- (D) es-mol

80. Në cilën shkallë është dhënë ky fragment muzikor?

- (A) G-dur
- (B) h-mol
- (C) D-dur
- (D) A-dur

81. Në cilin opion është dhënë saktë rënditja e tingujve të shkallës b-mol melodike?

- (A) b-c-des-es-f-ges-as-b
- (B) b-c-des-es-fes-g-as-b
- (C) b-c-des-es-f-ges-a-b
- (D) b-c-des-es-f-g-a-b

82. Cili modus (shkallë e vjetër kishtare) është dhënë në këtë shembull? (shembulli i bazuar në shkallën As-dur)?

- (A) Modusi eolik
- (B) Modusi frigjik
- (C) Modusi miksolidik
- (D) Modusi dorik

83. Intervali i dhënë në shembull (es1 - fis2) është:

- (A) nonë e zmadhuar
- (B) nonë e zvogëluar
- (C) decimë e zmadhuar
- (D) decimë e zvogëluar

84. Cili interval (i përbërë) është dhënë në këtë shembull?

- (A) Tercëdecimë e zmadhuar
- (B) Duodecimë e zmadhuar
- (C) Tercëdecimë e vogël
- (D) Kuartdecimë e vogël

85. Sipas ndarjes së intervaleve në konsonancë dhe disonancë, intervali i dhënë në këtë shembull është:

- (A) disonancë e ashpër
- (B) konsonancë e përsosur
- (C) disonancë e butë
- (D) konsonancë e papërsosur



86. Cili nga opcionet (A, B, C, D) e paraqet sekstën e zmadhuar telartë nga tingulli “es”?

- (A) es - ces
- (B) es - ceses
- (C) es - cisis
- (D) es - cis

87. Cili lloj i kuintakordit është dhënë në këtë shembull?

- (A) Kuintakord i madh
- (B) Kuintakord i vogël
- (C) Kuintakord i zvogëluar
- (D) Kuintakord i zmadhuar



88. Sekstakordi i gr. IV në f-mol harmonike është:

- (A) d - f - b
- (B) dis - f - b
- (C) des - f - b
- (D) d - fis - b

89. Ndërto septakordin e vogël Dur nga nota “As”?

- (A) as - c - es - g
- (B) as - ces - e - ges
- (C) as - ces - es - ges
- (D) as - c - es - ges

90. Në çfarë pozite dhe vendosje është paraqitur ky akord?

- (A) Pozitë e oktavës me vendosje të gjërë
- (B) Pozitë e kuintës me vendosje të ngushtë
- (C) Pozitë e oktavës me vendosje të ngushtë
- (D) Pozitë e tercës me vendosje të gjërë



91. Cila lidhje harmonike është paraqitur ndërmjet këtyre dy akordeve?

- (A) Lidhje e rreptë
- (B) Lidhje gjysëm e lirë
- (C) Lidhje e lirë
- (D) Lidhje e kombinuar




92. Lidhje e rreptë (strikte) në mes gradëve kryesore quhet kur:

- (A) tingulli i përbashkët mbahet
- (B) tingulli i përbashkët lëviz
- (C) tingulli i ndieshëm mbahet
- (D) tingulli i ndieshëm lëviz


93. Cili lloj i kuartsekstakordit është paraqitur në këtë shembull?

- (A) Kuartsekstakordi mbajtës i përgatitur
- (B) Kuartsekstakordi paraardhës (anticipues)
- (C) Kuartsekstakordi kalimtar
- (D) Kuartsekstakordi kthyes



94. Cili lloj i kadencës është paraqitur në figurë?

- (A) Autentike
- (B) Plagale
- (C) Jonike
- (D) Dorike



95. Cili rrotullim i septakordit dominant është dhënë në këtë shembull? (shkalla b-mol)

- (A) Septakordi dominant
- (B) Terckuartakordi dominant
- (C) Kuintsekstakordi dominant
- (D) Sekondakordi dominant



96. Si ndërtohet një sekundakord i vogël-mol nga tingulli F?

- (A) F-G-B-D
- (B) F-G-H-D
- (C) F-G-H-Des
- (D) F-G-B-Dis

97. Në këtë shembull është dhënë nonakordi dominant. Gjeneri në cilin zë është vendosur intervali i nonës?

- (A) Zëri i basit
- (B) Zëri i altit
- (C) Zëri i sopranit
- (D) Zëri i tenorit



98. Dominanta jashtëtonale për cilën gradë është dhënë në këtë shembull? (shkalla D-dur)

- (A) D → II
- (B) D → III
- (C) D → IV
- (D) D → VI



99. Cili akord i alteruar është dhënë në këtë shembull? (shkalla fis-mol)

- (A) Sekstakordi i zmadhuar (italian)
- (B) Sekstakordi lidik
- (C) Sekstakordi napolitan
- (D) Sekstakordi i DD



100. Cili akord i alteruar kromatik është dhënë në këtë shembull? (shkalla g-mol)

- (A) Sekstakordi i zmadhuar (italian)
- (B) Terckuartakordi i zmadhuar (francez)
- (C) Kuintsekstakordi i zmadhuar (gjerman)
- (D) Kuintsekstakordi dy herë i zmadhuar (skerjabinit)





Qershor, 2023